



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i posaçëm parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin European”.

PROCESVERBAL

Tiranë, më 5.11.2024, ora 16:00

TRYEZË TEMATIKE PUBLIKE II

Drejton tryezën: Ilda Muçmataj

Rendi i ditës:

Parandalimi i korrupsionit në sektorin privat dhe ndërtimi i një shoqërie me integritet përmes rolit të shoqërisë civile.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Etilda Gjonaj dhe Esmeralda Dida.

Të ftuar:

Ilda Muçmataj, Jonida Rystemaj, Monika Canco, Sofjana Veliu, Ardita Seknaj, Eda Noçka, Teisi Kurti, Stela Suloti, Martin Jorgaqi, Marsel Llukmani, Besa Velaj, Elona Hoxhaj, Kiara Kapaj, Jona Doko, Nirvana Deliu, Adela Tagani, Majlinda Thomaj, Mirilind Polovina, Orjada Hyska, Jura Citozi, Ejnxh Pepa, Elona Shiba, Esmeralda Ballesha, Isuf Shehu, Giulia Re, Isabele Thomas Delic, Aleksander Maskovic, Basil Hahn, Adam Norikan, Erisa Lame, Nikolin Jaka, Arben Shkodra, Leonard Busho, Zenel Hoxha, Erion Prifti, Luan Bregasi, Andi Kananaj, Erion Banushi, Klajdi Tozaj, Migena Konda, Klajd Karameta, Denar Biba, Nina Guga, Elona Hoxha, Marcela Kerçeku, Krisi Kllapi, Arbër Basholli, Silvana Ramadani, Sara Kapoli Rovenë Pregja, Jona Suli, Rudina Thanasi, Sofjana Veliu, Ardita Skëndaj dhe Entrid Islami.

HAPET MBLEDHJA

Ilda Muçmataj – Ju falënderoj për pjesëmarrjen!

Mua më quajnë Ilda Muçmataj. Jam pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Sot jam në cilësinë e drejtueses së tryezës së mirëpritur në ambientet e Kuvendit. Së bashku me koleget e mia dhe anëtarët e shoqërisë civile, jemi pjesë e grupit të ekspertëve pranë komisionit të posaçëm parlamentar, i cili është krijuar dhe synon thellimin e reformave për aderimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian për vitin 2030. Puna e komisionit fokusohet në tri shtylla kryesore: mirëqeverisja, antikorrupsioni dhe sundimi i ligjit, dhe secila prej tyre përfshin disa kapituj ose komponentë.

Shtylla e dytë, lufta kundër korrupsionit përfshin 5 kapituj dhe sot do të prezantohet një ndërthurje midis një pjese të analizës së dokumentit analitik të kapitullit të dytë, konkretisht “Parandalimi dhe lufta kundër korrupsionit në sektorin privat” dhe kapitullit të pestë “Ndërtimi i një shoqërie me integritet”. Ky grupim është bërë për shkak të ndërlidhjes që kanë këta komponentë me njëri-tjetrin, duke mbajtur në konsideratë që korrupsioni është një fenomen kompleks, që prek të gjithë sektorët e shoqërisë, çdo segment të saj dhe normalisht edhe përgjigjja ndaj tij duhet të jetë gjithëpërfshirëse, duke përfshirë jo vetëm sektorin publik, por edhe sektorin privat, shoqërinë civile, biznesin, gjithashtu, akademinë dhe qytetarët në tërësi.

Analiza do të prezantohet me *PowerPoint* nga personeli akademik dhe shoqëria civile dhe përmban arritjet, situatën aktuale, gjetjet kryesore, problematikat e evidentuara, si edhe nevojat për ndërhyrje. Në fund janë paraqitur disa teza për diskutim publik. Çdo prezantim do të zgjasë rreth 15 minuta dhe pas secilit prej prezantimeve, jeni të ftuar dhe kemi nevojë për kontributin tuaj, të paraqisni komente, sugjerime, propozime apo edhe rekomandime. Përmbledhjet ekzekutive të analizës së dokumentit analitik të punës gjenden në faqen zyrtare të Komisionit të Posaçëm Parlamentar, të cilat janë lehtësisht të aksesueshme dhe të konsultueshme prej secilit prej jush.

Pa dashur të zgjatem shumë dhe për t’ua kaluar fjalën kolegeve të mia, dua t’ju përmend se metodologjia e përdorur në dokumentin analitik të punës mbështetet në një sërë raportesh; raportet e Bashkimit Europian, raportet e organizatave ndërkombëtare, si OECD-SIGMA dhe shumë të tjera, kuadri ligjor në fuqi, dokumentet strategjike dhe të politikave të qeverisë, raportet periodike të institucioneve publike dhe institucioneve të pavarura, raportet e shoqërisë civile në këtë fushë, si dhe analiza dhe të dhëna sasiore dhe cilësore, dhe një sërë dokumentesh të tjera.

Korrupsioni në sektorin privat, edhe pse ndonjëherë është i anashkaluar në diskutime, ndikon drejtpërsëdrejti në mjedisin ekonomik, në investime, por edhe në zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë në tërësi, ndaj ftoj në prezantim profesorin e asociuar Jonida Rustemaj, pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë, e cila së bashku me zonjën Monika Canco, gjithashtu, pedagoge e Fakultetit të Drejtësisë, do t'ju prezantojnë gjetjet dhe çështjet për adresim të analizës në lidhje me parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit në sektorin privat.

Jonida Rustemaj – Faleminderit, Ilda!

Gjithashtu, ju falënderoj për pjesëmarrjen!

Duke qenë se kemi kufizim kohor, dua të kaloj menjëherë në prezantim, së pari, lidhur me rëndësinë që ka analiza e kryer për masat parandaluese në sektorin privat.

Ashtu sikurse Ilda e ceku pak në hyrje, sektori privat ka qenë përgjithësisht jashtë vëmendjes së shtuar në luftën parandaluese për korrupsionin. Fokusi është vendosur përgjithësisht në sektorin publik, megjithatë ka pasur ndërhyrje, ka pasur masa të zbatuara edhe ndaj sektorit privat, që përfshijnë përgjithësisht ligjin për sinjalizuesit, për regjistrin e pronarëve përfitues dhe akte të tjera.

Pse është e rëndësishme që analizës t'i nënshtrohet edhe sektori privat? Kjo lidhet kryesisht me nevojën për të pasur një luftë gjithëpërfshirëse ndaj korrupsionit, sepse shpeshherë e kemi parë fenomenin e korrupsionit të lidhur vetëm me autoritetet publike, por ndërkohë harrojmë që sektori privat përfaqëson anën e ofertës në fenomenin e korrupsionit në tërësi. Prandaj, në këtë analizë ne jemi përqendruar përgjithësisht në evidentimin e instrumenteve që janë zbatuar deri tani në parandalimin e luftës ndaj korrupsionit dhe problematikave që janë ndeshur në zbatimin e tyre, si dhe hapësirave në kuadrin rregullues të veprimtarisë së tyre.

Nga pikëpamja metodologjike se si është ndërtuar analiza në fokus ka qenë tregu, duke u drejtuar tek operatorët, pra te subjektet private, qoftë tek operatorët në përgjithësi, qoftë te subjekte të caktuara që veprojnë në tregjet specifike, ku ka një ndjeshmëri më të shtuar, siç janë tregjet financiare. Po ashtu, në fokus të analizës kanë qenë edhe ndërmarrjet shtetërore, të cilat ndonëse në pronësi publike operojnë në treg dhe normalisht duhen vendosur në kushte të barabarta gare me subjektet private. Analiza për sektorin privat nuk do të ishte e plotë nëse do të linim jashtë saj autoritete, të cilat kanë kompetenca mbikëqyrëse apo rregullatore në treg.

Cilat janë disa nga problematikat kryesore që kemi konstatuar gjatë fazës së përgatitjes së dokumentit analitik? Sigurisht, ky dokument është ende në fazën e një dokumenti draft, që do të

përmirësohet dhe do të plotësohet bashkë me kontributet që do të vijnë nga tryezat e realizuara për këtë qëllim.

Pikë së pari, për shkak të asaj çfarë nisa të thosha pak më përpara, lidhur me faktin që sektori privat ka qenë përgjithësisht jashtë vëmendjes në luftën ndaj korrupsionit, ka pak studime apo analiza të thelluara që të matin gjerësinë dhe përhapjen e fenomenit të korrupsionit në këtë sektor, ndaj kjo përbën edhe një nga sfidat me të cilat jemi ndeshur gjatë hartimit të dokumentit analitik. Sikurse e theksova, ka një sërë masash me karakter parandalues që janë aktualisht në fuqi, të cilat kanë dhënë efektet e tyre, por sigurisht ka ende nevojë për përmirësim.

Disa nga gjetjet dhe problematikat kryesore lidhen kryesisht me mungesën e instrumenteve specifike për parandalimin e korrupsionit në sektorin privat dhe forcimin e integritetit të subjekteve tregtare. Për hir të së vërtetës, kuadri rregullues ligjor shqiptar, që fokusohet në rregullimin e organizmit dhe funksionimit të brendshëm të subjekteve tregtare në përgjithësi, nuk parashikon në mënyrë të qartë rregulla apo procedura për menaxhimin e riskut të korrupsionit në shoqëri.

Gjithashtu, kemi një kod jodetyrues për drejtimin e brendshëm apo i njohur si *Corporate Governance*, por që nuk ka prova për zbatimin e tij në praktikë dhe, gjithashtu, mungojnë praktikat konkrete të zbatuara në funksion të forcimit apo rritjes së integritetit në sektorin privat.

Në aspektin represiv, aktualisht është në fuqi ligji për përgjegjësinë penale të personave juridikë, i cili është miratuar në kuadër të nevojës për t'u standardizuar me aktet ndërkombëtare. Megjithatë, është konstatuar se ky ligj nuk parashikon sanksione të përshtatshme për veprat penale në fushën e korrupsionit. Gjetjet e raportit të OECD-së theksojnë se vlera maksimale e gjobës që zbatohet në rastin e veprave penale në fushën e korrupsionit nuk është e përshtatshme. Në raport me ligjin për regjistrin e pronarëve përfitues, ndonëse është një ligj që është përshëndetur dhe ka ndikuar në rritjen e transparencës për identifikimin dhe zbulimin e pronarit fundor, ai sërish mbart problematika. Së pari, sepse parashikon një përqindje të lartë, pra identifikohen vetëm pronarët që zotërojnë më shumë se 25% të kuotave apo të aksioneve në kapitalin e shoqërisë, si dhe aktet në zbatim të tij lejojnë që në rastin e pamundësisë për t'u identifikuar pronarët, të vijohet me regjistrimin e anëtarëve të organeve drejtuese. Veçanërisht kjo paraqet një problematikë në rastin kur këto shoqëri bëhen pjesë e garave për fonde publike dhe është shumë e vështirë të identifikohen rastet e konfliktit të interesave kur nuk identifikohen se cilët janë pronarët përfitues fundorë.

Gjithashtu, raportet kanë konstatuar që kuadri rregullues nuk ka miratuar konventën e OECD-së, ndonëse Kodi Penal ka parashikuar veprën penale të korrupsionit të nëpunësve publikë

të huaj. Disa nga propozimet kryesore në këtë sektor lidhen, së pari, me krijimin e kulturës së integritetit brenda sektorit privat, si përmes krijimit të njësive që do të identifikojnë dhe menaxhojnë riskun e korrupsionit, ashtu edhe e plotësuar kjo me hartimin e instrumenteve për forcimin e integritetit apo programeve të posaçme antikorrupsion, duke ndjekur gjithmonë standardet dhe modelet më të mira të zbatuara në Europë. Në drejtim të kuadrit rregullator, disa nga propozimet kryesore lidhen me rishikimin e ligjit për përgjegjësinë penale, për të adresuar nivelin e gjobave. Ndoshta kjo është pjesë edhe e punës së grupit që është duke punuar për Kodin Penal, megjithatë ne nxjerrim si një gjetje që lidhet me fushën e korrupsionit.

Njëherësh propozojmë ndryshimin e ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues, i cili do të ofronte më shumë transparencë dhe do të siguronte një qasje më të qëndrueshme të luftës ndaj korrupsionit, së bashku me ratifikimin e konventës së OECD-së për luftën kundër ryshfetit ndaj nëpunësve publikë të huaj.

Gjithashtu, është e nevojshme që mes sektorit publik dhe privat të sigurohet apo të arrihet një bashkëpunim më i madh, i materializuar në formën e veprimeve të bashkërenduara, qoftë në drejtim të shkëmbimit të eksperiencave, qoftë në ndihmën që sektori publik mund të sigurojë ndaj atij privat për shkak të eksperiencës më të gjerë që ka në drejtim të hartimit të instrumenteve të integritetit.

Lidhur me tregjet specifike, gjithashtu, një nga kufizimet në analizimin e këtyre tregjeve lidhet me mungesën e akteve, e dokumenteve apo analizave. Megjithatë, jemi përpjekur që të dhënat t'i mbledhim drejtpërdrejt nga faqet *ueb* të institucioneve financiare, duke pasur përgjithësisht fokus sektorin bankar edhe atë të shoqërive të sigurimit, duke qenë se tregu i kapitaleve është jo tërësisht funksional. Është konstatuar një mungesë transparence lidhur me publikimin në faqen e tyre *ueb* të politikave ose të rregulloreve për menaxhimin e konfliktit të interesit, të kodeve të drejtimit të brendshëm dhe të programeve të posaçme antikorrupsion. Gjithashtu, për këta sektorë është konstatuar se mungojnë mekanizmat për raportimin e rasteve të korrupsionit përtej atyre kanaleve që krijon ligji për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Ashtu sikurse e theksova edhe pak më sipër, pjesë e analizës kanë qenë edhe autoritetet që kanë kompetenca mbikëqyrëse apo rregullatore në treg. Lidhur me këto autoritete është konstatuar që ndonëse ligjet përkatëse rregulluese përmbajnë kërkesa kryesisht formale, ligjore për emërimin, për kriteret që duhet të plotësojnë anëtarët e tyre, nuk ka kërkesa të qarta, substanciale për

kontrollin e pastërtisë së figurës për drejtuesit e lartë, si dhe mekanizma institucionale për verifikimin e thelluar të këtyre kriterëve.

Gjithashtu, gjen rregullim të kufizuar vendosja e kufizimeve para dhe pas punësimit lidhur me anëtarët e organeve, autoriteteve me kompetenca mbikëqyrëse dhe rregullatore. Në këtë drejtim, për të adresuar problematikat e konstatuara më lart sugjerojmë forcimin e transparencës së institucioneve financiare përmes kodeve të drejtimit të brendshëm, të rregulloreve të konfliktit të interesit dhe hartimin e instrumenteve të posaçme antikorrupsion si nevojë për të forcuar integritetin institucional.

Njehsimi i përmbajtjes së Kodit të Sjelljes është sërish një propozim, i cili vjen për të rritur dhe për të forcuar integritetin institucional të institucioneve financiare. Ndërsa në raport me autoritetet mbikëqyrëse dhe rregulluese të tregut, për të shtuar dhe për të rritur besimin e publikut në tregun në tërësi, por edhe në veprimtarinë e autoriteteve mbikëqyrëse, sugjerojmë kontrollin e pastërtisë së figurës për drejtuesit e autoriteteve mbikëqyrëse dhe kontrolluese, si dhe përcaktimin e një kuadri të plotë ligjor për rregullat e para dhe pas punësimit për anëtarët që luajnë një rol kyç në vendimmarrjen e organeve me kompetenca mbikëqyrëse të tregut.

Gjithashtu, edhe këto organe duhet të bëhen pjesë e linjës apo e listës së gjatë të organeve të administratës publike që kanë hartuar dhe janë duke zbatuar instrumentet e integritetit.

Së fundi, ashtu sikurse e theksova edhe në hyrje të prezantimit, objekt studimi kanë qenë edhe ndërmarrjet shtetërore, të cilat ndonëse operojnë në tregun privat janë në pronësi publike dhe këtu standardi duhet të jetë shumë më i lartë sesa në sektorin privat.

Problematikat që janë konstatuar lidhen me mungesën e një transparence gjithëpërfshirëse që lidhet me aspektet operacionale dhe financiare të ndërmarrjeve shtetërore. Gjithashtu, është konstatuar që pronësia është e copëzuar, e fraksionizuar midis autoriteteve të ndryshme publike dhe nuk ka një njësi të vetme për të koordinuar objektivat e qeverisjes apo të drejtimit të brendshëm të ndërmarrjeve shtetërore. Problematika janë ndeshur, gjithashtu, edhe në nivel organizativ apo organizimi, sepse raportet e OECD-së kanë konstatuar që në përbërje të këshillave të ndërmarrjeve shtetërore, përgjithësisht ka individë të lidhur me politikën në rolin e zëvendësministrave apo këshilltarëve të ministrave, të cilët janë ndjeshëm më të ekspozuar ndaj riskut të korrupsionit.

Për ta përmbyllur, disa nga propozimet për ndërhyrjen kryesore në ndërmarrjet shtetërore lidhen kryesisht me rritjen e transparencës përmes sigurimit të një regjistri publik për të gjitha ndërmarrjet së bashku, ku të publikohen edhe aspektet e veprimtarisë së tyre dhe aspektet

financiare, konsolidimi i sistemit të qeverisjes së brendshme të ndërmarrjeve, duke siguruar pavarësinë e këshillit dhe profesionalizmin e tyre; krijimi i një strukture të posaçme që të koordinojë politikat e qeverisjes së brendshme të ndërmarrjes, si dhe hartimi i instrumenteve për forcimin e integritetit dhe të etikës në ndërmarrjet shtetërore.

Pjesë e prezantimit janë edhe konkurrenca dhe inspektimet ndaj subjekteve tregtare, ndaj unë po ia kaloj fjalën koleges Monika Canco, për të vijuar me këto çështje.

Faleminderit!

Monika Canco – Përshëndetje!

Ju falënderoj për pjesëmarrjen!

Kur flasim për luftën kundër korrupsionit dhe parandalimin e tij, është e nevojshme të ndalemi edhe te konkurrenca dhe te ndihma shtetërore në treg. Në përgjithësi në këtë sektor, edhe sipas progresraportit të fundit të Bashkimit European, kuadri ligjor i Shqipërisë është gjerësisht në përputhje me *acquis*-në e BE-së, megjithatë ne kemi vënë re që një pjesë e legjislacionit sekondar të Bashkimit European është përafuar në akte të Autoritetit të Konkurrencës, në rregullore, udhëzime, vendime, por jo në ligjin për mbrojtjen e konkurrencës.

Gjithsesi, për t'u fokusuar te çështjet që lidhen më ngushtësisht me antikorrupsionin, fillimisht marrëveshjet për përcaktimin e ofertës ndërmjet operatorëve ekonomikë në prokurimet publike ose *bid rigging*, siç quhet gjithashtu në një tjetër terminologji, janë të aplikueshme dhe ndodhin edhe në Shqipëri. Procedura të tilla nuk janë të rregulluara në mënyrë të posaçme nga ligji për mbrojtjen e konkurrencës dhe kjo mund të ndikojë negativisht në procedurat për prokurimin publik.

Gjithashtu, një tjetër problem është çështja e ndihmës shtetërore apo *state aide*. Ndihma shtetërore është asistencë financiare shtetërore ose e një lloji tjetër, e cila u jepet subjekteve të caktuara tregtare në kushte në veçanta, por me kushtin që duhet të plotësohen kriteret e konkurrencës, pra të mos shtrembërohet konkurrenca.

Lidhur me këto problematika, ne kemi propozuar edhe disa nevoja për ndërhyrje kryesore. Së pari, është nevoja për rregullimin ligjor, në lidhje me marrëveshjet midis operatorëve ekonomikë për përcaktimin e ofertës në prokurime. Zakonisht këto janë marrëveshje që lidhen me përcaktimin e çmimit minimal ose maksimal të ofertës, në lidhje me ndarjen e tregjeve e të tjera. Në fakt, neni 4 i ligjit për mbrojtjen e konkurrencës aktualisht rregullon marrëveshjet e ndaluara, gjithsesi nuk specifikon apo nuk detajon mundësinë e korrupsionit te këto marrëveshje shumë të

rezikshme. Gjithashtu, Autoriteti i Konkurrencës ka hartuar disa udhëzime në lidhje me *bid rigging*, pra me këtë problem, por gjithsesi ne mendojmë se adresimi më i mirë i këtij problemi do të ishte një ndryshim ligjor, një amendim ligjor, pra një ligj, në kuptimin formal.

Sa i përket ndihmës shtetërore, ne kemi evidentuar nevojën për marrjen e masave efektive për garantimin e pavarësisë së komisionit të ndihmës shtetërore. Sipas progresraportit të fundit, ekziston një *blueprint* i një plani në lidhje me disa opsione të mundshme, sa i përket zgjidhjes së këtij problemi. Është e nevojshme që komisioni i ndihmës shtetërore të mos jetë i lidhur me ekzekutivin, ashtu siç është aktualisht, dhe të jetë i pavarur, një detyrim ky që lidhet jo vetëm me parashikimet e progresraporteve të Bashkimit Europian, por njëkohësisht është i nënshkruar nga Shqipëria në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit. Për këtë arsye ne mendojmë se kjo ndërhyrje është e nevojshme.

Lidhur me rolin e inspektimeve të subjektet tregtare, risia më e madhe në këtë fushë është pa dyshim miratimi i ligjit të ri nr. 99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Ligji i vjetër, i cili vazhdon të jetë aktualisht në fuqi deri sa të shfuqizohet nga ligji i ri, kishte disa probleme dhe ato që lidhen kryesisht me çështjet e antikorrupsionit që janë: mungesa e një procesi të përzgjedhjes së subjekteve të inspektimit, në bazë të një vlerësimi të riskut, gjë që linte hapësira për abuzime; gjithashtu mungesa e vlerësimit të performancës së inspektorateve për ndikimin që ato kishin në përmbushje të detyrimeve ligjore, gjë që sërish sillte dhe linte mundësinë e problematikave. Ligji i ri “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” ka potencialin t’i adresojë problematikat e vjetra, me hyrjen e tij në fuqi.

Sa u përket çështjeve të antikorrupsionit, do të nënvizoja shqyrtimin e ankimit administrativ në nivel qendror, pra ankimi ndaj një inspektorati nuk do të trajtohet më nga vetë inspektorati, por në nivel qendror nga Inspektorati i Përgjithshëm. Në këtë mënyrë do të shmanget mundësia e ndonjë konflikti interesash, në këtë rast. Gjithashtu, një element pozitiv sa i përket këtij ligji, lidhur gjithmonë me antikorrupsionin, është reduktimi i inspektimeve të paprogramuara, të cilat ishin të shumta në volum dhe linin hapësira për abuzime të mundshme.

Sa u përket propozimeve për ndërhyrje kryesore në këtë fushë, ne mendojmë që është e nevojshme të specifikohet më tej në ligj se cilat janë burimet e tjera të ligjshme të financimit të Inspektoratit të Përgjithshëm. Sipas nenit 12 të ligjit, Inspektorati i Përgjithshëm financohet nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera të ligjshme, gjithsesi nuk specifikohet nëse donacionet apo

sponsorizimet janë një prej burimeve të mundshme dhe, nëse janë, se si mund të shmanget konflikti i interesave me donatorët potencialë.

Një tjetër propozim për ndërhyrje lidhet me detajimin e funksionimit të komisionit disiplinor, tashmë në nivel qendror, pranë Inspektoratit të Përgjithshëm, përmes akteve normative me fuqi nënligjore, siç parashikohet edhe nga ligji, gjë që duhet të arrihet të realizohet në një kohë sa më të shpejtë, në mënyrë që të shmanget mungesa e parashikimit nga ana e bizneseve.

Gjithashtu, është e nevojshme rritja e transparencës dhe efikasitetit të veprimtarisë inspektuese, përmes zgjerimit të mëtejshëm të platformës digjitale të procedurave të inspektimit, përmirësimit të platformës aktuale të inspektimeve *online* dhe publikimit të rezultateve të inspektimeve për publikun, patjetër duke pasur parasysh edhe kufizimet ligjore.

Së fundmi, është vërejtje që një pjesë e inspektorateve nuk kanë, të paktën të publikuar, një plan integriteti, prandaj është i nevojshëm forcimi i integritetit institucional përmes hartimit dhe zbatimit të instrumenteve të integritetit për inspektoratet.

Ilda Muçmataj – Faleminderit, zonja Canco, për prezantimin e sfidave, në kuadër të parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit, në lidhje me sektorin privat, me tregjet financiare bankare e jobankare dhe ndërmarrjet shtetërore, si dhe konkurrencën, ndihmën shtetërore dhe inspektimet!

Në përfundim të prezantimit, jeni të mirëpritur për diskutime, sepse normalisht është i nevojshëm kontributi juaj për të paraqitur komente, sugjerime apo rekomandime, në lidhje me gjetjet e analizës, kështu që fjala është për ju.

Denar Biba – Së pari, ju falënderoj për ftesën dhe për gjithçka po bëni!

Pritshmëritë janë të larta, thjesht doja të vija në dukje, edhe si pjesë e bashkëpunimit, i cili, po të kishte qenë pak më i hershëm, do të ishte edhe më mirë, se prej gati 2 vjetësh ka nisur një punë, e cila tashmë ka përfunduar, dhe për mbi 1 vit e gjysmë Autoriteti i Konkurrencës i ka detajuar në një draftligj thujse të gjitha problematikën që u listuan këtu, janë detajuar edhe të gjitha variacionet që merr *bid rigging* në prokurimin publik dhe janë marrë thujse të gjitha direktivat e fundit. Legjislacioni ynë, sikundër thuhet edhe në progresraportin e fundit, është thujse i përfunduar me *acquis*-në e BE-së, kështu që në këtë pikë i ngelet legjislatori, pak më herët ekzekutivit, sepse i takon Ministrisë së Ekonomisë të jetë iniciatorja, pasi ne nuk kemi kapacitet legjislativ për ta çuar më shumë se kaq. Ne operuam si draftues, sepse na ishte lënë detyrë nga Kuvendi i Republikës,

por tashmë drafti është në Ministrinë e Ekonomisë, kështu që ne vetëm presim të shkojë përpara, të vijë përpara legjislatorit dhe të miratohet sa më shpejt. Në fakt, duhet të ishte miratuar.

Faleminderit!

Ilda Muçmataj – Faleminderit!

A ka sugjerime apo komente të tjera?

Luan Bregasi – Përshëndetje!

Jam Luan Bregasi nga “Biznes Albania”. Është kënaqësi të jemi në këtë komision. E kemi mirëpritur, e kemi mbështetur, e kemi pëlqyer fokusin e këtij komisioni. Kemi edhe përfaqësuesit tanë, të cilët japin kontributin e vet me propozime për të përmirësuar situatën, sidomos në lidhje me marrëdhëniet dhe problemet e korrupsionit.

Këtu u bënë disa propozime të rëndësishme, të cilat janë shumë të rëndësishme për t’u zbatuar. Sigurisht, korrupsioni duhet trembur më shumë, jo kaq pak sa dëgjuam në propozimet tuaja. E vërteta është ajo që thatë edhe ju, që ofertën e korrupsionit ndonjëherë e bën edhe sipërmarrja dhe ne kemi përgjegjësinë tonë në këtë çështje, por ne jemi të shqetësuar për ta sistemuar dhe për ta korrigjuar këtë fenomen. Në fillimet e veta, kur kjo mazhorancë mori pushtetin (e kam thënë edhe në disa mbledhje të tjera), Kryeministri Rama tha një gjë, e cila atëherë u duk pak e çuditshme, që nuk ka njerëz të korruptuar, por ka sisteme të korruptuara në Shqipëri. Sigurisht, përpjekjet për t’i përmirësuar sistemet janë absolutisht të lavdërueshme. Sot kemi mjaft shërbime të cilat i marrim *online*, nuk shkojmë nëpër sportele, dhe kjo është një nga pikat me të cilat luftohet korrupsioni, që biznesi të ketë sa më pak kontakte me punonjësit shtetërorë, me ata që i ofrojnë këto shërbime. Realisht, në përmirësim të sistemeve është bërë shumë, edhe në tatime, edhe në dogana, edhe në shërbimet e tjera që ne marrim, si në kadastër e të tjera.

Problemi që dua të ngre është që shteti, krahas përmirësimit të sistemeve, duhet të përmirësojë edhe njerëzit që u shërbejnë këtyre sistemeve, që e kryejnë këtë shërbim. Po ju them se na kanë ardhur shumë raste nga organizatat tona, ku aplikojnë për të njëjtën gjë për 10 subjekte, të cilat kanë të njëjtin problem, dhe marrin përgjigje të ndryshme. Këtu fajin e ka sistemi, apo e kanë njerëzit të cilët janë të papërgatitur për t’i shërbyer këtij sistemi? Kështu që, mendojmë se ka ardhur koha të bëhen përpjekje maksimale për të sistemuar dhe për të rritur anën profesionale të njerëzve të cilët do t’i shërbejnë këtij sistemi. Tani sistemet janë më përpara se njerëzit. Dikur njerëzit ishin pak më përpara se sistemet, tani sistemet janë më përpara dhe njerëzit më mbrapa.

Pra, nga ana subjektive nuk funksionon. Këtë shqetësim e kam ngritur edhe herë tjetër dhe gjej vendin për ta ngritur edhe në këtë komision.

Së dyti, ka ende për t'u përmirësuar. Ligji për inspektimet është një ligj shumë i mirë, ne kemi dhënë kontributin tonë. Ky është ligji i parë që ktheu Presidenti, por fatmirësisht Parlamenti e miratoi përsëri, sepse ka qenë shumti i mirëpritur nga ne sipërmarrësit. Ashtu sikundër kur është miratuar ligji për konkurrencën (meqenëse foli edhe Denari), disa ligjeve nuk u kemi kushtuar shumë vëmendje, të cilat sot japin një impakt të jashtëzakonshëm edhe për të luftuar korrupsionin, por edhe për të nxitur e zhvilluar klimën e konkurrencës në Shqipëri, kështu që ka ardhur koha, tashmë që vëmendja është edhe më e madhe, edhe nga ana e biznesit, edhe nga ana e qeverisë, por edhe njerëzit janë më të përgatitur dhe bëhen ligje edhe më të mira, t'i kushtojmë vëmendje pikërisht ligjit të inspektimeve, ligjit të konkurrencës, ligjit të prokurimeve publike, në të cilat ka vend për përmirësim. Këto janë disa ligje që, në fakt, e nxisin dhe e stimulojnë korrupsionin.

Së fundmi, duke e mbyllur diskutimin tim, ndoshta beteja për ta përmirësuar sistemin e drejtësisë nuk ka mbaruar, madje ne, biznesmenët, kemi krijuar përshtypjen se, kur u bë vetingu, frika ishte e madhe, por tashmë që këta janë pastruar nga vetingu, duhet të shikoni edhe pjesën që ka ngelur në sistem, që nuk ka më frikë. Korrupsioni nuk përfundoi me largimin e disa figurave nga drejtësia, nga sistemet që u kontrolluan. Nuk po them që t'i rikthehem, por ndoshta duhet menduar që, për shembull, një herë në 5 vjet duhet ta bëni vetingun e drejtësisë, që edhe këta të cilët e kanë kaluar vetingun ta dinë që pas 5 vjetësh do të kontrollohen përsëri, sepse, siç e thashë, korrupsioni duhet të frikësohet. Këtu korrupsioni nuk ka frikë fare.

Faleminderit!

Kam shumë besim se ky komision do të hartojë propozime dhe sugjerime, të cilat do ta përmirësojnë edhe klimën e biznesit, do të luftojnë edhe korrupsionin dhe do të kemi më shumë besim që në Shqipëri do të sundojë ligji dhe jo mungesa e rregullit dhe e konkurrencës.

Faleminderit!

Ilda Muçmataj – Faleminderit, zoti Bregasi!

A ka komente, sugjerime, diskutime të tjera?

Po, zoti Jaka.

Nikolin Jaka – Faleminderit!

Në radhë të parë, faleminderit për ftesën!

Në fakt, thjesht prezenca e përfaqësuesve të sipërmarrjes këtu tregon se sa të rëndësishëm janë për sipërmarrjen private dhe se sa delikatë janë në punën e saj të përditshme korrupsioni dhe fenomenet korruptive.

Unë do të bëj një parashtrim shumë të thjeshtë. Për të parë se sa e pakorruptuar është një shoqëri, mjafton të shohësh indikatorët e klimës së biznesit, se sa i favorshëm është ai vend për të bërë biznes, sepse, duam apo nuk duam, të gjitha janë të konvegjuara aty ku është interesi dhe interesi është te sipërmarrja private. Pra, një shoqëri e ndershme dhe e udhëhequr në mënyrë të ndershme krijon edhe klimën e duhur për të bërë biznes. Nëse sipërmarrja private ndihet mirë në iniciativën e vet dhe në implementimin e sipërmarrjes së vet, kjo do të thotë se ai vend i ka plotësuar të gjithë indikatorët e zhvillimit, të integritetit dhe të prosperitetit.

Ne tani jemi prezentë dhe unë do të doja të vlerësoja në përgjithësi të gjithë ata që kanë marrë nismën për luftën kundër korrupsionit, do të doja të përshëndesja edhe ministren me të cilën jemi takuar shpesh, kemi bërë edhe tryeza dhe kemi diskutuar. Ajo që ne shohim është se, megjithëse ka një simbolikë të jashtëzakonshme në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike, ku 95% e tyre, të evidentuara sot, jepen *online*, pra janë shërbime, që e kanë eliminuar komunikimin fizik. Mirëpo ndodh rëndom që edhe këto shërbime kthehen në bumerang për biznesin, për shembull, ka një periudhë njëvjeçare, nuk e di pse jam i bindur që jo vetëm biznesi, por edhe çdo qytetar shqiptar e ka hasur këtë vit, që kadastra nuk ka funksionuar. Ka një metodë: AV1, AV2 dhe AV3, pastaj duhet të bësh përsëri aplikimin nga e para, një maratonë e paimagjinueshme, që nuk e merr vesh se çfarë ndodh, si dhe një koordinim i punës, që hajde gjeje. Të paktën unë, edhe si qytetar, edhe si sipërmarrës, e kam hasur shumë shpesh këtë lloj modeli në ofrimin e shërbimeve. Pra, ka një mungesë profesionizmi të paimagjinueshme, kthehen përgjigje nga më të ndryshmet, derisa qytetarët dhe sipërmarrësit bëhen të marrin atë drejtimin drejt 6-ës, i themi ne sipërmarrësit, sepse burokracitë e mëdha e çorientojnë kokën e njeriut dhe merr rrugën e 6-ës.

Unë mendoj se ne duhet të jemi konkretë, pra nëse sipërmarrja paraqet një shqetësim, ne duhet të shkojmë për ta zgjidhur këtë gjë, sepse unë ju siguroj që ky shqetësim është edhe i qytetarëve shqiptarë, pasi të gjithë brenda janë. Kur bëhet fjalë për interesa dhe për prosperitet, të gjithë mundohen që në fund të ditës të punojnë për të realizuar kërkesat ekonomike familjare, dhe këtë e kemi të gjithë.

Nga ana tjetër, unë i ndoqa edhe propozimet që janë bërë në dy rastet e evidentuara nga komisioni, pra nga ekspertët, dhe mendoj se ka pasur nevojë për një koordinim me përfaqësitë: me

dhomat e tregtisë dhe me përfaqësitë e shoqatave, që përfaqësojnë sipërmarrjen private, sepse ne jemi të përditshëm.

Sot kemi firmosur dy kërkesa, një që i drejtohet Kuvendit dhe të gjithë qeverisë për paketën fiskale, është rast i rrallë që jemi në fund vitit dhe vazhdojmë të mos kemi një konsultim të paketës fiskale; i dyti është ligji për të dhënat personale, që ka kaluar në Parlament, edhe ky i pakonsultuar.

Nonsensi këtu është se gjoba për daljen e të dhënave personale për kompanitë shqiptare herën e parë është 10 milionë euro dhe herën e dytë 20 milionë euro. Unë nuk e kuptoj, a ka ndonjë sens nga ekspertët që bëjnë analiza të tilla dhe a ka një analizë se sa sipërmarrje qarkullojnë 10 milionë euro në vit? Sepse ne nuk jemi as ndërmarrje të vogla dhe të mesme, ne vazhdojmë të jemi mikro. Pra, nëse Bashkimi European këtë ligj e trajton me ndërmarrje të vogla, të mesme dhe të mëdha, ku në Bashkimin European qarkullimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme shkon deri në 300 milionë euro, në Shqipëri ndërmarrjet e vogla e fillojnë nga 100 mijë euro deri në 140 mijë euro; ndërmarrjet e mesme fillojnë nga 140 mijë euro deri në 500 mijë euro, pastaj të tjerat quhen të mëdha. Nuk ka sens që një ndërmarrje që ka një qarkullim vjetor 1 milion euro të ketë gjobën 10 milionë euro. Ku është proporcionaliteti këtu, apo ku është sensi i vendosjes së një gjëje të tillë, unë nuk e di, por, meqë kemi deputetë këtu në tryezë, është rasti për ta trajtuar.

Ndërkohë, ne duhet të jemi pak të kujdesshëm me kapitujt. Është një arritje shumë e madhe që mundëm të hapnin dhe të trajtonim kapitujt e negociatave dhe procesin e integritetit, por duhet të jemi të kujdesshëm, sepse, në radhë të parë, ne duhet të mbrojmë ekonominë e vendit tonë. Ju siguroj se Kroacia e ka vonuar me dëshirën e saj negocimin e kapitujve, vetëm për të mbrojtur ekonominë e saj.

Në përgjithësi bota është e ndërtuar në mënyrë të tillë, që secili vend të mbrojë ekonominë e tij dhe mbrojtjet ekzistojnë në çdo vend të botës në mënyrë të fshehur apo të pafshehur, por që mbrojnë sipërmarrjet e tyre. Të mos harrojmë, sot Shqipëria është ende në embrion të krijimit të ndërmarrjeve prodhuese, pra ne akoma nuk kemi statusin e prodhuesit shqiptar.

Ju nuk e besoni se çfarë ndodh, sepse nuk kemi pasur mundësi të diskutojmë, por, a është e pranueshme që ky produkt, që vjen nga jashtë, nuk i nënshtrohet doganës, në asnjë lloj elementi dhe përbërësi të tij, ndërsa kur ky produkt vjen si lëndë e parë për t'u prodhuar në Shqipëri, pjesët përbërëse, që bëjnë produktin fundor që prodhohet në Shqipëri, i nënshtrohen doganës? Pra, të mendojmë se sa të specializuar janë ekspertët, të cilët vendosin taksat doganore për të rënduar këtë. Këtu e kemi edhe konkurrencën, edhe tregun, edhe ndershmërinë, edhe pandershmërinë, edhe se

si funksionon dogana, edhe se si funksionon sistemi tatimor, dhe të gjitha këto mblidhen dhe krijojnë pakënaqësi tek tregu. Ka raste që thonë, dakord, po gjej një rrugë tjetër.

Lidhur me korrupsionin, si fenomen, Dhoma e Tregtisë, në analizat e saj që ka bërë edhe me ekspertë të ndryshëm, propozon, madje unë e kam propozuar edhe në një takim që bëmë me ministrin e Drejtësisë, të ketë lehtësi të ndjeshme për të gjithë sipërmarrjen për fenomenin: vepër penale për korrupsion. Pse? Sepse ne duhet të forcojmë zbatimin e ligjit.

Unë ju siguroj që, nëse një sipërmarrësi i mbyllet dera nga një administrator publik apo një përfaqësues i institucioneve publike, nuk ka ky shkon ky sipërmarrës për të dhënë ofertë. Nuk ka ofertë të njëanshme dhe ekzekutim të njëanshëm, është po kjo derë, po kjo zyrë, po kjo mundësi, që krijon mundësi të ketë korrupsion.

Ilda Muçmataj – Zoti Jaka, ju lutem, sepse duhet të ruajmë kohën e diskutimit, mbase në vijim të konsultimeve...

Nikolin Jaka – Ne mund ta lëmë fare, problemi është se sa sensitive janë këto gjëra. Nëse flasim për korrupsionin dhe për integrimin, shoqëria shqiptare mund të integrohet në Bashkimin Europian vetëm nëse do të jetë një shoqëri e ndershme, prosperuese, integruese dhe inovative, por nuk mund të jesh inovativ nëse fenomenet e korrupsionit të pengojnë në punën tënde.

Ne do t'ju dërgojmë të gjitha edhe me shkrim, si Dhomë e Tregtisë, në mënyrë që ju t'i keni parasysh se çfarë ndodh.

Faleminderit!

Ilda Muçmataj – Ju faleminderit, zoti Jaka!

Nuk e di nëse zonja Rystemaj vlerëson se duhet të plotësohet diçka.

Jonida Rystemaj – Faleminderit për kontributet!

Qëllimi i këtyre tryezave ka qenë të mblidhnim ndjeshmërinë e këtyre bizneseve lidhur me propozimet apo gjetjet paraprake që ne ndamë në tryezë. Për efekt të kohës na u desh t'i kalonim pak disa çështje, megjithatë, për t'ju dhënë një kontekst pak më të gjerë, dua t'ju sqaroj se cili ishte qëllimi i analizës për sektorin privat. Ky komponent është pjesë e një komponenti më të madh, që ka analizuar edhe ato aspektet që ju i prekët lidhur me shërbimet që merrni nga sektorë që kanë risk më të lartë korrupsioni, si: tatimet, doganat, kadastra.

Fokusi i çështjeve që ne prezantuam sot ka qenë përgjithësisht në ndërtimin e integritetit brenda sektorit privat, që lufta të jetë e fokusuar në dy fronte kryesore, pra nëse, nga njëra anë, kemi një sistem represiv, ndëshkues në fuqi, nga ana tjetër, duhet të punojmë edhe për forcimin e

integritetit institucional të organizatës, përmes këtyre programeve antikorrupsion, që ndikojnë jo vetëm në forcimin e integritetit individual, pra të atyre që përbëjnë organizatën, por edhe të subjektit në tërësi. Ky ka qenë qëllimi.

Lidhur me politikën penale, unë iu referova një konstatimi nga OECD-ja, ishte sugjerim i tyre që vlera maksimale e gjobës për veprat penale në fushën e korrupsionit duhet të ndryshojë, mundësisht për t'u përshtatur apo për të zgjedhur një mënyrë tjetër përlllogaritjeje, që mund të lidhet përgjithësisht me përqindjen nga xhiroja vjetore që mund të realizojë një subjekt tregtar. Megjithatë, sikurse e thashë, ndoshta kjo çështje është objekt diskutimi në tryezën që po drafton Kodin Penal, unë këtu e nxora vetëm si një gjetje në kuadrin e masave represive kundër korrupsionit.

Gjithsesi, unë ju falënderoj për kontributet, të cilat i mirëpresim që të pasurojmë dhe plotësojmë edhe gjetjet paraprake.

Ju falënderoj!

Ilda Muçmataj – Ju falënderoj, zonja Rystemaj!

Nuk e di nëse ka komente të fundit, sugjerime apo propozime?

Në fazën e masave paraprake do të konsultohen të gjitha grupet e interesit bashkë me Dhomën e Tregtisë.

Atëherë, mund të vijojmë me pjesën e dytë, që i referohet krijimit të një shoqërie me integritet. Fokusi i krijimit të një shoqërie me integritet është parë në dy këndvështrime: së pari, mundësitë ligjore dhe institucionale për mbështetjen e aktorëve të shoqërisë civile, ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe brezave të rinj në programet arsimore për ndërtimin e një shoqërie me integritet dhe parandalimin e korrupsionit, dhe, së dyti, mekanizmat ligjorë dhe institucionalë për raportimin, ndjekjen e rasteve të korrupsionit nga qytetarët, denoncuesit, sinjalizuesit, aktorët e shoqërisë civile, grupet e interesit, me fokus të veçantë mekanizmat e mbrojtjes dhe garancitë e denoncuesve.

Në këtë drejtim ftoj në prezantim zonjën Ardita Senkaj, përfaqësuese e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, dhe zonjën Sofjana Veliu, pedagoge e Universitetit European të Tiranës.

Sofjana Veliu – A mund ta ndjek nga këtu?

Faleminderit të gjithëve!

Ashtu siç u përmend më parë, analiza që ne kemi ndërmarrë në këtë fazë lidhet me ndërtimin e një shoqërie me integritet. Më duhet ta them që në fillim se trajtimi që ne i kemi bërë temës në këtë drejtim shkon përtej luftës së korrupsionit. E kemi parë në një hapësirë shumë më të gjerë. Konkretisht fokusi i prezantimit tonë do të jetë në tri dimensione. Kemi analizuar hapësirën civile, duke parë ndërveprimin me institucionet, në kuadër të pjesëmarrjes qytetare, të të gjitha grupeve joqeveritare në politikëbërje dhe në ndjekjen e këtyre çështjeve, kemi parë mekanizmat dhe mjetet që janë në dispozicion të aktorëve dhe të publikut, gjithashtu, edukimin dhe ndërgjegjësimin.

Në këtë kuadër unë do ta filloj me pyetje, që do të shkojë në tërësi. Ajo që kemi synuar është të shikonim se ky qëndron hendeuku i krijimit të besimit, nëse ka, dhe çfarë mekanizmash apo hapash duhen të ndjekim më vonë për t'i forcuar akoma dhe më shumë.

Po kaloj te dimensionin e parë, që është hapësira civile.

Shumë shkurtimisht, nëse më ndihmoni me *slide-in* tjetër, nga analiza jonë është krejt e qartë që Kushtetuta parashikon të gjitha hapësirat për lirinë e tubimit, të organizimit, të organizimit kolektiv dhe të drejtën e peticionit, dhe kjo përbën një aspekt pozitiv për të thënë se jemi në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Për të vijuar nga pikëpamja strukturore, se si shoqëria civile mund të lëvizë dhe është organizuar brenda territorit të Shqipërisë, janë një seri nismash, që janë ndërmarrë ndër vite dhe këtu mund të konstatojmë krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, udhërrëfyesin për politikën qeverisëse drejt një mjedisi të mundësueshëm për zhvillimin e shoqërisë civile. Gjithashtu, duhet të përmendim që, përpos Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile, ka edhe një seri këshillash të tjerë ndërveprues midis sektorit publik, shoqërisë civile, sektorit privat dhe palëve të tjera të interesit, të cilët prekin specifikisht aspektet ekonomike dhe shoqërore të vendit. Ndërkohë, në aspektin e ndërveprimit një nga konstatimet pozitive në vijimësi, është edhe strategjia e re kombëtare kundër korrupsionit, e cila u lançua ditën e djeshme. Ndër masat e shumta të ndërmarra aty, bashkëveprimi me të gjithë këta aktorë joqeveritarë është thelbësor, dhe kjo vlen për t'u përmendur, sepse, përpos të gjitha masave që janë vendosur, e rëndësishme është të theksohet që përgjegjësia është edhe te palët e tjera, gjithmonë në kuptimin e mirë të fjalës.

Në aspektin e pjesëmarrjes në mirëqeverisje dhe politikëbërje kemi ligjin “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, i cili në përgjithësi është në përputhje me standardet e BE-së, gjithashtu,

edhe projektligji “Për vullnetarizmin”, që vjen si një kërkesë për ndryshim, së fundi në tetor u njoftua fillimi i procesit të konsultimit.

Tani do të kalojmë te gjetjet, sepse, përveç arritjeve që u konstatuan, ka edhe disa gjëra, që kërkojnë më shumë adresim, dhe këtu do të donim bashkëpunimin dhe rekomandime të mëtejshme nga ju. Më konkretisht, ato që kemi identifikuar kanë të bëjnë kryesisht me strukturat dhe ligjet që i përmenda pak më parë.

Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile kërkon ndryshime në mënyrën e funksionimit, të qeverisjes strukturore të brendshme, ligji “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse” i miratuar në vitin 2021, nuk është akoma plotësisht funksional, kjo për arsye se pritej që deri në fund të vitit 2023 të ishte krijuar regjistri i organizatave jofitimprurëse, i cili nuk është krijuar akoma. Krijimi i këtij regjistri do të krijonte një hapësirë shumë më të mirëregulluar, më korrekte dhe më të qartë për aktorët, rolet dhe ekspertiza që ata mund të ofrojnë në mbështetje të politikëbërjes. Gjithashtu, kemi edhe udhërrëfyesin për politikën qeverisëse drejt një mjedisi mundësues. Siç e shikoni, nga pjesa e zbatueshmërisë ka qenë plani 2019-2023, ndërkohë që është akoma i papërditësuar, kështu që përkon me një kërkesë deri diku emergjente për t’u filluar.

Ndërkohë, te ligji “Për vullnetarizmin” siç e shihni, ne kemi vendosur të dyja aspektet, duke qenë se në ligjin e mëparshëm është kërkuar, edhe sipas organizatave dhe shumë vrojtimeve që janë bërë, të ketë më shumë angazhim, në mënyrë që jetë më efektiv dhe më i zbatueshëm, dhe me shumë mundësi projektligji i ri “Për vullnetarizmin” do t’i adresojë këto çështje. Ajo që konstatuam është se për momentin nuk aksesohet drafti i ri. Kështu që, edhe kjo mund të jetë diçka për t’u diskutuar.

Nga konteksti praktik, proceset e konsultimit publik vijnë të konsiderohen pothuajse formale, si në nivelin e ekzekutimit të akteve që vijnë nga ekzekutivi, ashtu dhe të Parlamentit. Kjo ka të bëjë me faktin e llogaridhënies dhe transparencës, të cilat mungojnë në respekt të dhënies së përgjigjeve ndaj rekomandimeve që janë dhënë nga aktorët joqeveritarë dhe publikimit të tyre, pra të bërit të ditur për publikun.

Ajo që kemi konstatuar, kjo nga ana tjetër vlen për ta parë të balancuar situatën, ka të bëjë me pjesëmarrjen e ulët të aktorëve në procesin e konsultimit. Në *slide*-in e fundit do të jap edhe disa shifra për ta bërë më konkret këtë rekomandim.

E fundit, ka të bëjë me të drejtën e petitionit, e cila është vërejtur që nuk adresohet në mënyrë të njëtrajshme dhe të ditur në institucione të ndryshme, e cila do të mundësonte një trajtim më të harmonizuar mes institucioneve dhe një angazhim më proaktiv nga ana e aktorëve të tjerë.

Në raport me agjencinë “Për mbështetjen e shoqërisë civile”, disa nga çështjet dhe problematikat në lidhje me këtë institucion kanë të bëjnë me mungesën e transparencës, po ashtu edhe të llogaridhënies, sidomos për dhënien e granteve të shoqërisë civile, në identifikimin e fushave dhe nëse ka një përthithje të vëmendjes akoma më shumë në fushat, siç janë: lufta kundër korrupsionit apo promovimi i integritetit në shoqëri.

Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile, siç e përmenda, është një format formal dhe jo shumë aktiv. Mendohet që funksionimi i tij duhet të jetë më i gjerë dhe të plotësojë të gjithë mandatin që i lejohet.

Një tjetër aspekt, duke e parë edhe nga brenda, ka të bëjë me kapacitetet e pamjaftueshme aktualisht në vend në raport me organizatat që ushtrojnë funksionet e *watch dock*-it, janë shumë të limituara në numër dhe kjo kërkon një analizë më të mirë për të adresuar këtë mangësi.

Për të kaluar te hapësira e dytë që janë mekanizmat, konkretisht vetëm për mekanizmat avokuese. Ne kemi identifikuar mekanizma digjitale dhe mekanizma të formatit fizik. Regjistri elektronik për njoftime dhe konsultime publike dhe platforma e konsultimit në Kuvend, janë të dyja platforma digjitale funksionale. Ndërkohë që disa nga platformat e formatit fizik, siç e përmendëm më parë, janë akronime, si Këshilli Kombëtar i Shoqërisë Civile, Këshilli i Punës, Këshilli Ekonomik Kombëtar, ai i investimeve, ai tatimor e të tjerë. Për të plotësuar të gjithë kuadrin kemi Këshillin Kombëtar për Integrimin Europian dhe platformën e partneritetit të integritetit europian. Kjo e fundit edhe pse ka pasur një përmirësim të dukshëm në mënyrën e organizimit dhe funksionimit, gjithsesi kërkohen më shumë përpjekje për sa i takon llogaridhënies, transparencës, edhe për të tria platformat, për mënyrën e tyre funksionale në raport me publikun.

Për ta bërë këtë më të dukshme, ne kemi aksesuar dhe analizuar të dhënat nga regjistri elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike. Ky regjistër në 4 -5 vjetët e fundit ka pësuar përmirësime të dukshme për sa i takon përdorimit të tij, në njëfarë mënyre është pothuajse komplet funksional. Ajo që vihet re është se kemi një përmirësim të dukshëm për sa u takon akteve të nxjerra për konsultim, në raport me aktet totale të nxjerra nga ekzekutivi, akte të konsultuara fizikisht përmes takimeve, pra jep edhe një pasqyrë pak më të gjerë rreth mënyrës se si janë bërë konsultimet. Pra, nuk janë mjaftuar vetëm në aspektin digjital, por janë organizuar edhe tryeza të

tjera individuale, ku janë rreth 70 dhe 81% për vitin 2023. Aktorët qeveritarë në total për gjashtëmujorin e parë të vitit 2024 janë 81%, ndërsa në vitin 2023 ka një numër relativisht më të lartë. Pra, viti 2023 është evidentuar si një ndër vitet me pjesëmarrje më të madhe në konsultimet publike.

Ajo që është shumë shqetësuese në identifikimin e këtyre raporteve ishte pjesëmarrja me komente në konsultime, ku vetëm rreth 11% e pjesëmarrësve në konsultime dërgojnë komente për aktet. Në këtë drejtim mekanizmat avokues kërkojnë, gjithashtu, një vëmendje të caktuar.

Përveç mekanizmave avokues, kemi edhe mekanizmat e tjerë, si ato denoncuese, për të cilat mund të na flasë zonja Sofjana Veliu.

Sofjana Veliu – Meqenëse Ardita bëri edhe moderimin, pa humbur kohë po vazhdoj aty ku e la kolegja, sepse kemi qenë në një grup pune për pjesën e panelit të dytë, ndaj kemi menduar të bëjmë një ndarje, qoftë edhe për çështje metodologjike, duke marrë shkas edhe nga angazhim ynë në tërësi.

Gjithsesi, më lejoni të shpreh kënaqësinë time që jam pjesë e këtij paneli shumë të rëndësishëm dhe që isha pjesë e grupit të punës! Me këtë rast përshëndes koleget e mia, për angazhimin dhe për korrektësinë në bashkëveprimin mes nesh!

Pa humbur kohë, për të qenë korrekte me menaxhimin e kohës, po ndalem te mekanizmat denoncues, sepse siç e tha edhe Ardita pak më parë, ne i kemi ndarë mekanizmat në dy pjesë, në mekanizma avokues dhe denoncues.

Pikë së pari, duhet të përmendim progresin dhe arritjet që janë bërë në lidhje me mekanizmat, ndaj kemi menduar ta fillojmë me platformën e bashkëqeverisjes, si një angazhim shumë i mirë dhe frutdhënës. “Shqipëria që duam” ka dhënë frytet e veta dhe kjo ka qenë pjesë e nënvizimit të bërë nga raportprogreset, qoftë ai i Shqipërisë i vitit 2023, ku vlerësohet që në kuadrin institucional, për parandalimin e korrupsionit, ka pasur disa zhvillime dhe përsëri, qoftë në atë të vitit 2024 ku shohim një nënvizim pothuajse në të njëjtat terma, ku, edhe me mangësitë që mund të ishin evidentuar gjatë raportprogresit të vitit 2023, Shqipëria vlerësohet që ka krijuar disa institucione kundër korrupsionit me burime financiare dhe njerëzore në rritje. Si shembull konkret, ju e dini që në vitin 2024 u krijua Ministria e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, e cila njëkohësisht luan rolin e koordinatorit kombëtar kundër korrupsionit dhe është përgjegjëse për pjesën e administratës publike në luftën kundër korrupsionit. Pra, kjo shihet si një risi, por edhe si një angazhim që po jep frytet e veta.

Gjithashtu, nëse do ta vlerësonim te progresi dhe arritjet, një nismë shumë e mirë është koordinimi ndërmjet Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, e cila në kuadër të ristrukturimit dhe transferimit në varësi të këtij institucioni, ushtron kompetencat e veta në bazë të denoncimeve të bëra kryesisht nëpërmjet koordinimit të korrupsionit me 26 institucione dhe agjenci publike.

Nuk janë vetëm progreset dhe arritjet, por duhet të nxirrnim edhe problematikat që lidhen me mekanizmat denoncues. Në një kuadër ligjor institucionet kanë ndërmarrë një sërë masash për të forcuar gjithë strukturën e krijimit të mekanizmave përgjegjës dhe trajtimit të rasteve të denoncimit të korrupsionit. Megjithatë, pavarësisht përpjekjes së qeverisë, lidhur me angazhimet për rritjen e denoncimeve, mund të themi që përsëri, në kontekstin ligjor dhe institucional, ka mangësi dhe nënvizohen problematika. Për shembull, në kontekstin ligjor ne kemi bërë dy ndarje, fillimisht kemi kapur kontekstin ligjor në lidhje me problematikat dhe kontekstin institucional.

Për sa i përket kontekstit ligjor ligji nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizimeve”, i ndryshuar”” luan një rol të rëndësishëm për sa i përket sinjalizimit të korrupsionit në sektorin publik dhe privat. U nënvizua edhe pak më herët në lidhje me këtë pjesë, që miratimi i ligjit është vlerësuar pozitivisht, por gjithsesi kjo nuk do të thotë se është shmangur numri i ulët i sinjalizimeve, për sa u përket rasteve korruptive.

Në një analizë të bërë nga të dhënat e raporteve të ILDKPI-së, në harkun kohor 2018 – 2023, por edhe të raporteve ndërkombëtare, rezulton se numri i sinjalizimeve sa vjen dhe ulet. Kjo është reflektuar edhe në raportin e shtetit të së drejtës, të vitit 2024. Pra, ngelemi në ata terma të nënvizimeve që bëhen nga raportprogreset.

Gjithashtu, për sa u përket mjeteve efektive që duhet të përdorim në lidhje me sinjalizimin ose nxitjen e sinjalizimeve, përsëri shohim një nivel të ulët, pra nuk kemi aq sinjalizime sa kemi pritshmëri. Pavarësisht kësaj, ILDKPI-a ka marrë një sërë masash administrative me gjobë në rastet e refuzimit të mbrojtësve të sinjalizuesve.

Një problematikë tjetër që e kemi ndeshur për sa i përket kontekstit ligjor, përveç ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizimeve”, i ndryshuar””, rezulton të jetë në fuqi edhe ligji nr. 9508... (*shkëputje audio*)...bashkëpunimin e publikut në luftën kundër korrupsionit. Në këtë drejtim duket sikur ka një mbivendosje për sa u përket dy ligjeve dhe këtë e kemi nënvizuar te sugjerimet tona, që është mirë të shmangen se mund të krijohet konfuzion nga mbivendosja potenciale mes dy ligjeve.

Për sa i përket kontekstit institucional ka një mbivendosje potenciale të kompetencave në adresimin e denoncimeve për rastet e sinjalizimeve dhe të denoncimeve, pra për të dyja rastet. Edhe në raportprogreset e fundit për Shqipërinë theksohet se mbeten sfida, që duhet të adresohen, në lidhje me vëmendjen ndaj sektorëve me risk të lartë ndaj korrupsionit, për rishikimin e kapaciteteve të koordinimit në luftën ndaj korrupsionit, për masat antikorrupsion, për sigurimin e koordinimit efektiv dhe bashkëveprimin që mund të kenë institucionet, përfshirë këtu institucionet në nivel lokal. Megjithatë, nuk mund të shmangen problematikat që janë krijuar nga bashkekzistenca e disa institucioneve ose strukturave me kompetenca pothuajse të njëjta, gjë që edhe qytetarët i bën më konfuz në drejtim të denoncimit të një rasti korruptiv. Kjo është përfshirë edhe te gjetjet tona, si mbivendosje potenciale e përgjegjësiive ndërmjet institucioneve që mund të kenë të njëjtë kompetencë.

Një element i dytë i panelit tonë, që është jo më pak i rëndësishëm edhe pse duket se është në fund, mendoj se është thelbi i të gjitha gjetjeve tona, ka të bëjë me edukimin dhe ndërgjegjësimin. Nuk mund të lë pa përmendur progreset dhe arritjet që janë bërë, sepse në një fokus të rëndësishëm, për sa i përket parandalimit të korrupsionit, në Shqipëri ka qenë edhe edukimi ligjor. Kjo mund të jetë realizuar nëpërmjet organizatave jofitimprurëse dhe mbështetjes së partnerëve ndërkombëtarë, që gjithmonë kanë qenë të pranishëm në këto nisma.

Vlen të përmendet kuadri strategjik, që ka pasur një rol të rëndësishëm në rritjen e ndërgjegjësimin, për rëndësinë e zbatimit të ligjit. Mund të përmend strategjinë për edukimin ligjor të publikut dhe planin e veprimit 2020-2023. Gjithashtu, janë bërë disa marrëveshje bashkëpunimi shumë të rëndësishme nëpërmjet koordinimit ndërkombëtar antikorrupsion dhe Ministrisë së Arsimit, bashkë me ambasadën italiane, e cila ka qenë një përvojë shumë frytdhënëse, sepse ka mundur të krijojë një risi për sa i përket pasurimit të kurikulave universitare, duke përfshirë tema në lidhje me antikorrupsionin dhe sidomos parandalimin e këtij fenomeni.

Në vijim mund të përmend Koordinatorin Kombëtar kundër Korrupsionit, i cili ka zhvilluar takime të hapura dhe forume diskutimesh me nxënës të klasave të 10-ta dhe të 12-ta, pikërisht këtu e shohim mekanizmin efektiv apo “thembrën e Akilit”, që duhet të fillojmë me fëmijët para ciklit universitar.

E fundit, për sa i përket edukimit dhe ndërgjegjësimin në lidhje me progreset dhe arritjet, mund të përmendim këtu pjesën e angazhimit të organizatave të shoqërisë civile në bashkëpunimin me koordinatorin kombëtar në luftën kundër korrupsionit dhe me Drejtorinë e Përgjithshme

Antikorrupsion. Ndaj në këtë aspekt mendoj se është bërë një hap i mëtijshëm në forcimin e bashkëpunimit institucional, për sa i përket ndërtimit të shtyllave të integritetit dhe shoqërisë me integritet.

Po kështu, në progresraportin e vitit 2024 përmendet se është bërë një progres në krijim e platformës së partneritetit të integritetit europian, për tavolina konsultimi dhe diskutimi, që në fakt, është ajo çfarë i duhet edukimit dhe ndërgjegjësimit në lidhje me këtë aspekt.

Ilda Muçmataj – Faleminderit për prezantimin, sepse prekët aspektet ndërgjegjësuese, edukuese dhe parandaluese!

Fjala është për ju, nëse keni diskutime apo komente.

Slide-i fundit për temat për diskutim publik.

E Ftuar – Ndoshta për ta adresuar diskutimin, zoti Bregasi, praktikisht në vijimësi të gjithë kësaj, ne kemi ngritur disa teza për diskutim, për të marrë edhe më shumë informacion edhe nga ju që operoni çdo ditë në treg dhe keni hasur më shumë nga këto aspekte. Si mund të përmirësohen platformat e avokimit aktualisht, me synim ndërveprimin e llogaridhënies dhe të transparencës? Në aspektin e mekanizmave, nga ato çfarë pak a shumë paraqitëm, çfarë aksionesh apo veprimesh të menjëhershme mund të përmirësojnë dhe rrisin besimin në përdorimin e këtyre mekanizmave? Si mund t'i angazhojmë të rinjtë akoma më shumë dhe t'i bëjmë pjesë të luftës kundër korrupsionit, por edhe të promovimit të integritetit dhe të akteve të mira që bëhen nga gjithë faktorët?

Një aspekt tjetër që duam ta diskutojmë me ju është nëse ka disa shembuj të mirë apo disa praktika që ju mendeni se janë me vlerë për t'u aplikuar dhe për t'u zbatuar në Shqipëri dhe mund të inkurajojnë edhe më shumë pjesëmarrjen qytetare në këtë drejtim.

Gjithashtu për pjesën e burimeve njerëzore, si mund t'i rrisim këto burime? A ka nevojë emergjente për të pasur më shumë aspekte në edukim, në kërkim shkencor, në të dhëna në lidhje me korrupsionin, që mund të ndihmojnë politikëbërësit, por edhe aktorët e tjerë për të adresuar më mirë rekomandimet apo politikat e tyre?

Unë po e lë të hapur pastaj çdo gjë tjetër përveç këtyre janë të mirëpritura.

Ilda Muçmataj – Faleminderit!

Fjala është për ju nëse keni diskutime apo sugjerime.

Luan Bregasi – Faleminderit!

Po e them përsëri që ne e shikojmë shumë të rëndësishëm këtë komision, sepse në fillim u përgojua se jo po ky komision ka objekt sistemin e drejtësisë, por e vërteta është se ky është një

komision shumë serioz, sepse ne kemi përfaqësuesit tanë që na informojnë për këtë gjë. Pra, shikoj një mision të jashtëzakonshëm për të përmirësuar klimën e të bërit biznes, për të përmirësuar sundimin e ligjit dhe për të luftuar korrupsionin. Prandaj kemi ardhur vetë këtu, sepse e kemi vlerësuar këtë gjë. Sinqerisht, i falënderoj të gjithë ata që e udhëheqin këtë proces, por po them një gjë konkrete. Ne po vuajmë, sepse nuk jemi këtu vetëm për të propozuar, por hedhim disa ide dhe ata, që janë më të ditur se ne, mund t'i artikulojnë në forma ligjore, në formë rekomandimesh dhe po sjellim ndonjë shqetësim, pastaj janë gjëra për t'u menduar, nuk është se do të bëhet kështu siç themi ne apo ku di unë. Ne shikojmë që fuqia administrative e shtetit tonë nuk funksionon. Domethënë, një shtet duhet të funksionojë në mënyrë administrative; duhet t'i zgjidhë gjërat në mënyrë administrative. Shteti ynë, punonjësit tanë ose administratat tona për gabimet e paraardhësve e kanë më të thjeshtë të thonë: po, shiko, ti ke të drejtë, por shko zgjidhe në gjykatë. Një gjë është shumë e rëndësishme: gjykatat janë mbushur me gjykime, për shkak se nuk funksionojnë zgjidhjet administrative. Ndonjëherë kjo ndodh edhe për mungesë të qartësisë ligjore, ndonjëherë edhe për mungesë të integritetit profesional të njerëzve që duhet ta zgjidhin një çështje, një ngërç në mënyrë administrative, por këtu futet pak edhe korrupsioni. Pra, shiko, se mund ta zgjidh, por është një lloj presioni. Prandaj kjo gjë të korrigjohet, sidomos në ligjin e kadastrës, sepse ka shumë gjëra të diskutueshme, dhe pothuajse pjesa më e madhe e gjyqeve, që kanë bizneset nëpër gjykata, lidhen me pronat, lidhen me çështjet që lidhen me hipotekat. Kështu që, unë mendoj se, në kuadër të përmirësimit të sundimit të ligjit, të përmirësimit të lehtësimit të punëve të biznesit, me qëllim dhe me objektiv të largët për të luftuar korrupsionin, duhet të rritet fuqia administrative e administratës sonë: të na japin zgjidhje; të na kthejnë përgjigje në rrugë administrative; t'i japin të drejtën në rrugë administrative atij që ka të drejtë, pastaj në gjykatë të shkojë ai që ka korruptuar një punonjës dhe në mënyrë të paligjshme ka regjistruar një bllokim në një pronë dhe duhet 10 vjet të heqim një shënim që ka bërë një njeri para 10 vjetësh. Pra, ka shkuar në një pronë dikush dhe i ka dhënë një lekë një punonjësi dhe shkruan te kjo kontratë që ka shitur këtë tokën këtu (në mënyrë të paligjshme) ose ka regjistruar një gjë jashtë vendimit të komisionit. Ti do të shkosh në gjykatë. Pse duhet të shkoj në gjykatë unë?! Në gjykatë duhet të shkojë ai tjetri, ai që e ka regjistruar në mënyrë të gabuar. Je i qartë që ky nuk është pronar?! Po, jam. Po pse duhet të shkoj unë në gjykatë?! Të shkojë ai që pretendon për këtë pronë. Unë e kam pronën. Ja ku e ke vendimin e komisionit. Pra, nuk e di, por propozimi dhe shqetësimi ynë është që fuqia administrative e shtetit duhet të përmirësohet, duke përmirësuar edhe njerëzit, duke rritur edhe integritetin e tyre, por edhe

duke bërë përmirësime ligjore. Ky është një problem që doja ta ngrija jashtë asaj që nuk m'u dha rasti ta thosha në pjesën e parë të diskutimit.

Shumë faleminderit!

Për shembull, janë këto AMTP-të. Pra, disa AMTP janë dhënë nëpër lagje, disa nëpër skuta, pra ti e ke këtu, e ke atje. Pra, disa AMTP janë hedhur në tokë truall. Për shembull, një pronar i madh, që ka shumë metra katrorë, ka edhe tokë bujqësore, ka edhe tokë truall, i themi ta rregullojë në mënyrë administrative, pra bizneset i thonë: kjo AMTP-ja, në rregull, ka një lloj forme ligjore, duhet respektuar, por çojë tek toka bujqësore, pse e ke çuar te toka truall, sepse pengon biznesin për ta zhvilluar këtë pronë. Pra, shumë gjëra, për të cilat duhet të marrë iniciativë dhe duhen administruar në mënyrë administrative. E thënë shkurt, siç e thashë në fillim, duhet të rritet fuqia administrative e shtetit tonë, që të funksionojë, sepse kjo është një mënyrë për të luftuar edhe korrupsionin.

Faleminderit!

Ilda Muçmataj – Faleminderit, zoti Bregasi!

Po.

Ju lutem, mund të prezantoheni!

Liljana Kondo – Jam eksperte ligjore për çështjet e konsultimit publik të përfshirjes dhe pjesëmarrjes qytetare dhe të organizatave të shoqërisë civile, njëkohësisht jam edhe eksperte lokale për kontrollin postlegjislativ me organizatën britanike WFD-i. Ju përgëzoj shumë për të gjitha gjetjet, për punën shumë cilësore dhe për të gjitha prezantimet. Doja që të përmendja disa pika. Për pjesën e sektorit të biznesit nuk është se e kam lexuar raportin paraprakisht, dhe nuk jam shumë në brendësi, por disa gjëra paraprake mund t'i ndaja. Te pjesa e kontrollit postlegjislativ të legjislacionit Kuvendi ka një rol shumë të rëndësishëm dhe forcimi i administratës dhe i ekzekutivit nuk vjen vetëm nga dhënia e fuqisë ekzekutivit, por rritja e llogaridhënies që ka ekzekutivi kundrejt Kuvendit. Kuvendi është sovrani që e kontrollon ekzekutivin, pra kontrollon se sa i ka zbatuar ligjet që ka nxjerrë Kuvendi ekzekutivi. Për shembull, ju përmendët shumë mirë ligjin “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë” dhe përmendët se nuk e kanë të përfshirë pjesën e korrupsionit si një nga veprat. Kjo mund të jetë një nga gjetjet që mund të ketë kontrolli postlegjislativ ose arsye të tjera pse ky legjislacion nuk është zbatuar aq sa duhet apo ligji për sinjalizuesit; cilat kanë qenë problematikat në zbatimin konkret. Pra, këto mund të jenë ligje shumë të mira candidate për të bërë kontrollin postlegjislativ nga ana e Kuvendit dhe për të thirrur në të

njëjtën kohë edhe aktorët e shoqërisë civile. Pra, konsultimi i kontrollit postlegjislativ është një kanal shumë i mirë për të thirrur dhe për të thithur shoqërinë civile në atë analizën *expost* pse nuk ka funksionuar ligji.

Për sa i takon pjesës së konsultimit publik paraprak të ligjeve, unë kisha disa komente, duke qenë se jam marrë gjerësisht me këtë proces dhe me gjetjet, që ju paraqitët edhe nga raportet e progresit dhe me atë shifër që ju e përmendët shumë drejt që 11% ishin komente, të cilat vinin nga shoqëria civile. Unë disa gjetje kryesore, që do të doja t'i ndaja me ju, janë te pjesa e informacionit të dhënë shumë herët, që duhet të publikohet për të gjithë aktorët, në mënyrë që shoqëria civile apo edhe sektori të kenë kohë që të përgatiten për të sjellë inpute cilësore; te pjesa e hartëzimit dhe identifikimit të atyre aktorëve që janë vërtetë relevantë. Pra, në momentin që diskutohet një legjislacion teknik, duhet të marrësh aktorët që kanë diçka për të sjellë, *think tank*-e apo institucione të tjera shkencore apo kërkimore, të cilat mund të japin një impakt.

Për sa i takon pjesës së bizneseve, tek etika janë ndërhyrjet represive, siç ju thatë, por janë edhe ndërhyrjet parandaluese. Pra, mendoj se detyrimet e etikës, të integritetit të bizneseve duhet të përfshihen në ligjin “Për shoqëritë tregtare”. Pra, ka ardhur kohë që të ketë një modernizim nga brenda dhe disa kërkesa shtesë për bizneset. Nga njëra anë është shumë e rëndësishme që të kemi një klimë të favorshme biznesi, por, nga ana tjetër, duhet të kemi edhe njëfarë balance dhe një biznes që është etik, së pari, dhe që janë të kontrollueshme pjesa e transparencës apo të gjitha ato që ju i përmendët shumë mirë, si dhe një ligj, ndoshta, Shqipëria është pak mbrapa, që është ligji “Për përgjegjësinë sociale të korporatave” që, me sa kam dijeni, ne nuk e kemi një ligj të tillë, por që është shumë i mirë për të shtyrë atë ndjeshmërinë sociale që kanë bizneset. Pra, në momentin që një biznes është i madh dhe funksionon në një territor të caktuar, atëherë ai ka një detyrim ndaj këtij komuniteti. Përveç detyrimeve tatimore, shtyrja e frymës dhe e kulturës së përgjegjësisë sociale të bizneseve ndaj komunitetit, përveç filantropisë që ne kemi një ligj, por është ende në fillimet e saj, besoj se janë shumë të mira për të shkuar në drejtim të parandalimit dhe krijimit të frymës pozitive në biznese.

Faleminderit!

Ilda Muçmataj – Faleminderit!

Denar Biba – Meqenëse tani po zbresim pak në një diskutim konkret, në fakt, unë nuk isha i përgatitur, por po përfitoj nga rasti për të lobuar për atë draftin që ne kemi paraqitur dhe që aktualisht gjendet në Ministrinë e Ekonomisë. Duhej të kishte shkuar në Kuvend shumë më herët,

minimalisht një vit më parë, por, siç duket, kalimi dhe ndarja e ministrive, sepse fillimisht ishte Ministria e Financave dhe Ekonomisë, tashmë ka krijuar atë problematikën e karakterit administrativo- burokratik.

Le t'i qëndrojmë korrupsionit, rolit, impaktit që ka Autoriteti i Konkurrencës në evidentimin, hetimin, pastaj në ndëshkimin potencial të marrëveshjeve të ndaluara në prokurimin publik.

Hetimi dhe ndëshkimi është pjesa më e lehtë e gjithë këtij procesi. Evidentimi i tyre është shumë i vështirë nga ana e Autoritetit të Konkurrencës, sepse duhet të vijnë sinjalizimet ose nga biznesi përmes një lloj bilbilfryrje private, ose nga autoritetet kontraktore. Problemi është se autoritetet kontraktore në një mënyrë ose në një tjetër, le ta themi mes nesh, supozohet të jenë të përfshira në atë rrethin vicioz të korrupsionit që është bërë ndërmjet pasivit dhe aktivit, ku në këtë rast ata janë pasivi, se aktivi është biznesi. Kështu që, edhe nga ata nuk ka iniciativë dhe nuk ka sesi të vijë. Atëherë si mund të ndodhë?! Te drafti që ne kemi paraqitur, e thashë që po përfitoj nga rasti për ta lobuar, disa gjëra duken të vështira kur i shikon për herë të parë, pavarësisht se në praktikën botërore ato janë prej vitesh edhe të suksesshme, por, kur i përflasin edhe në mjedise të tilla, fillon e na mësohet veshi, pastaj bëhen të thjeshta për t'u adoptuar në legjislacionin, pastaj nesër-pasnesër në praktikë. Ne kemi kërkuar akses të drejtpërdrejtë në të gjitha databazet e tatimeve, doganave dhe të prokurimit publik. Kur unë e kam thënë këtë edhe në mjedise informale, qoftë edhe me faktorë politikë, deputetë të Kuvendit, ka pasur një lloj stepje, pra si mund të keni ju akses në të gjithë databazën e prokurimit publik. Puna është se, nëse pritet, atëherë do të vazhdojmë si deri më sot, që ne do të presim se çfarë do të na vijnë sinjalizime nga autoritetet kontraktore ose nga Agjencia e Prokurimit Publik (një apo dy në vit nga Agjencia e Prokurimit Publik, këtu jemi) Në 3 vjet, që unë jam anëtar i Autoritetit të Komisionit të Konkurrencës, kemi një deri dy në vit nga Agjencia e Prokurimit Publik, ndoshta një ose dy nga Komisioni i Prokurimit Publik dhe asnjë nga autoritetet kontraktore. Ndoshta gaboj, por janë disa mijëra autoritete kontraktore në Republikën e Shqipërisë. Kështu që, e vetmja mënyrë është qasja proaktive, ku Autoriteti i Konkurrencës duhet të jetë ai që të hulumtojë dhe të hetojë, qoftë edhe përmes *red flag*-ve, që i merr nga media apo nga shoqëria civile, por posaçërisht nga media në lidhje me prokurime të ndryshme, të cilat ngrenë shqetësime, por, pa akses të drejtpërdrejtë, kjo është shumë e vështirë.

Së dyti, por kjo është çështje filozofie dhe shtetformuese, çfarë do të ndodhë, do ta lëmë te ndëshkimi administrativ rastin e evidentimit të praktikave abuzive në prokurimin publik, pra marrëveshjet e ndaluara ndërmjet operatorëve, apo do ta ngremë në vepër penale? Thjesht po e sjell në vëmendjen tuaj. Unë në këtë pikë ndaloj dhe nuk jap asnjë lloj sugjerimi, sepse e thashë që është totalisht çështje filozofie, shtetformuese kjo gjë. Ka vende të botës, Italia e ka vepër penale, ka vende të tjera, të cilat ndalojnë te ndëshkimi i karakterit civil-administrativ, ku edhe gjoba, që vendos një autoritet konkurrence, është i një niveli të tillë që mund ta nxjerrë krejt nga tregu operatorin që ka shkelur ligjin, por, gjithashtu, është praktikë po aq europiane edhe penalizimi i atij veprimi të paligjshëm.

Instrumentet me të cilat operon një autoritet konkurrence: ne vazhdojmë kemi një ligj, vjet festuam 20-vjetorin, i cili në makro është i përafëruar me *acquis*, por në lidhje me instrumentet, që ofrohen për evidentimin e marrëveshjeve të paligjshme daç në prokurimin e publik, daç në fushën e konkurrencës, është epokal dhe nuk ka asnjë lloj qasje me modernitetin në të cilin jemi sot. Është një ligj i vitit 2003, me disa amendamente komplet periferike të viteve 2006-2010, pa lidhje me këto, pra ne vazhdojmë luftojmë me pushkë druri në epokën e luftës kibernetike, ndërkohë që të gjithë kolegët tanë... Ne shkojmë e gjendemi në konferenca të ngjashme apo masivisht të këtij karakteri, ku flitet lufta ndaj korrupsionit, dhe mësojmë se si kolegët tanë kanë instrumente të ngjashme, me të cilat sot operon vetëm SPAK-u në Shqipëri, që nga aksesit i drejtpërdrejtë në *email*, në telefonat celularë, marrja e telefonave celularë nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës me ndihmën e Policisë së Shtetit, kur ata shkojnë dhe bëjnë edhe *dawn raid* përkatës. Sot është e paimagjinueshme, në kufijtë e qesharakes, që të pritët që ne t'i kapim te "*Rogner*"-i bizneset, duke nënshkruar ndonjë marrëveshje të paligjshme, duke stabilizuar çmime apo duke ndarë tregjet. Sot janë shumë më operative sesa kaq, ndërkohë që legjislacioni ynë në këtë fushë është arkaik.

Faleminderit!

Ilda Muçmataj – Faleminderit për komentet!

Po, nga shoqëria civile.

Mirela Arqimandriti – Përshëndetje!

Mirela Arqimandriti, nga Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim.

Faleminderit për tryezën dhe për tryezat, që ndoshta do të vazhdojnë për çështjet e korrupsionit në Shqipëri dhe shpresojmë të shkojmë drejt uljes së tij, pavarësisht se perceptimi është goxha i lartë sot që po flasim!

Unë doja të përqendrohesha pak në pjesën e dytë, sepse pjesën e parë të prezantimit nuk isha, sidomos në prezantimin e Arditës, dhe e falënderoj, sepse është ekzaktësisht ai realitet në lidhje me shoqërinë civile dhe ligjet përkatëse që janë bërë për të.

Këshilli Kombëtar i Shoqërisë Civile nuk funksionon; është shumë i dobët, edhe Këshilli i Barazisë Gjinore është jashtëzakonisht i dobët, me disa mbledhje, të cilat janë më shumë formale dhe priten të bëhen nga ministri, sepse, për shembull, ministri i Shëndetësisë e ka atë pozicionin udhëheqës ndaj këtyre dhe me të vërtetë që nuk funksionoi, nuk ka çështje aty që diskutohen. Unë vet, ashtu si edhe zonja në tryezë, jemi autoret e dy studimeve postlegjislative të ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” dhe ligjit “Për barazinë gjinore”. Ky i fundit është bërë në vitin 2021 dhe është prezantuar në legjislaturën e kaluar, ka kaluar edhe në komisionet përkatëse, por asnjë gjë nuk është bërë me rekomandimet, pavarësisht se u quajtën mjaft të rëndësishme. Po ashtu edhe ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i cili, gjithashtu, përfshin edhe pjesë korruptive si në sistemin e shëndetësisë, apo të policisë, aty ku raportohen rastet e dhunës, përsëri edhe për këtë nuk është bërë gjë akoma për ta përmirësuar dhe për të realizuar mekanizmin që ne kemi propozuar. Pra, vonesa kaq e gjatë në marrjen e masave, edhe pse kanë dalë dhe janë ngritur çështjet, është një çështje thelbësore për t’u përmirësuar.

Nga ana tjetër, ju thoni se si mund të përfshihen të rinjtë nëpër tryeza. Për këtë kemi Strategjinë për Edukimin Ligjor të Publikut, e cila është miratuar rreth vitit 2021, kur zonja Hysi ishte në legjislaturën e kaluar dhe e drejtonte këtë proces. Ne kemi qenë në tryezë dhe kemi krijuar edhe *network*-un, por që nuk funksionoi asnjëherë. Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut ka disa çështje mjaft të rëndësishme, por është e gjitha e pabuxhetuar. E njëjta gjë ndodh me shumë aspekte të strategjive të ndryshme, si Strategjia për Barazinë Gjinore që është deri në vitin 2030, por ndërkohë nuk kanë buxhete për pjesë të caktuara të tyre për t’u realizuar. Të gjitha këto pengojnë aspekte të caktuara, që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen efikase dhe inkurajimin e qytetarëve për të luftuar korrupsionin apo për të marrë pjesë në projekte monitoruese, edhe pse është roli i Kuvendit për të monitoruar dhe për të bërë analiza se si ka ndodhur, por ndoshta edhe analiza përpara sesa të miratohen ligjet.

Doja të ndalesha te konsultimi publik. Po është e drejtë, është shumë e vogël pjesëmarrja e shoqërisë civile dhe e ekspertëve në konsultimin publik, por kjo vjen sepse ligjet për konsultim publik (u evidentua edhe në një mbledhje të mëparshme që kishim këtu në Kuvend) dalin shumë pak në faqen e Kuvendit dhe duhet të jesh shumë i vëmendshëm për ta kontrolluar faqen. Ne marrim informacion, sepse jemi shumë aktivë në marrëdhëniet me Kuvendin dhe e falënderoj, sepse sa herë kemi kërkuar dëgjesa për aspekte të ndryshme e kemi pasur derën e hapur, por duhet rregulluar i gjithë sistemi. Nëse kemi disa ligje, disa strategji, të paktën të fillojmë realizimin e tyre 100% dhe më pas të flasim për aspekte të tjera. Këto doja të ngrija.

Po ashtu, një aspekt tjetër i rëndësishëm është për të drejtat e grave në tregun e punës, kryesisht grave në sektorin e fasonerisë, ku flasim për korrupsionin dhe ato ankohen, sepse mendojnë se të gjithë inspektorët e ndryshëm që vijnë për kontrolle në fabrikat e tyre, nuk i pyesin fare gratë apo punonjëset për çështje dhe aspekte të ndryshme që kanë të bëjnë me të drejtat në punë, me këshillat e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe aspekte të tjera, por qëndrojnë në zyrë me menaxherin, kontrollojnë thjesht disa dokumente. Në këto rrethana punonjëset mendojnë se aty ndodh edhe korrupsioni. Kjo ishte një çështje konkrete që doja ta ngrija.

Faleminderit!

Ilda Muçmataj – Faleminderit!

A ka komente apo sugjerime të tjera?

Po, zonja Pirdeni.

Adea Pirdeni – Faleminderit shumë, në radhë të parë, për ftesën!

E gjej me shumë vlerë faktin që gjatë këtij diskutimi ne jemi kryesisht në pozicion për të dëgjuar të gjithë analizën që është bërë. Gjej rastin këtu të përgëzoj ekspertet për punën e bërë dhe mbi të gjitha për dilgjencën e treguar në analizimin e një sërë aspekteve, të cilat kanë të bëjnë me luftën kundër korrupsionit!

Sikurse ju e sqaruat në krye të herës fokusi i tryezës së sotme është i kufizuar vetëm për çështje që kanë të bëjnë me integritetin në biznes dhe integritetin në tërësi në shoqëri. Besoj se në tryezat e ardhshme do të kemi mundësi që të angazhohemi në diskutim për çështje që kanë të bëjnë me integritetin e sektorit publik. Besoj se do të ngelen në diskutimin e tryezave të tjera, çështje që lidhen me këtë aspekt.

Fjalën doja ta merrja shkurtimisht më shumë për të ushqyer diskutimin sesa për të bërë debat në lidhje me disa nga çështjet që mendojmë se mund të jenë në vëmendje të diskutimit, të

rishikimit të analizës, apo edhe pjesë e debateve dhe e diskutimeve që do të vijojnë me punën e ekspertëve të angazhuar nga komisioni.

Në radhë të parë marr shkas nga raporti i progresit për Shqipërinë, i cili u publikua një javë më parë. Sikurse e dini është një nga dokumentet tona kryesore që udhëheq punën në këtë drejtim. Natyrisht, përveç raportit të progresit, sikurse ju e dini, Shqipëria ka miratuar një udhërrëfyes që është Udhërrëfyesi për Shtetin e së Drejtës, i cili udhëheq të gjithë punën e institucioneve shqiptare në drejtim të luftës kundër korrupsionit, sikurse është miratuar edhe Udhërrëfyesi për Reformën në Administratën Publike, i cili është një dokument që ka shërbyer, sikurse i pari, si një nga piketat hapëse të grupkategorive të para të negociatave.

Natyrisht që një pjesë e mirë e çështjeve që janë diskutuar këtu adresohen edhe në udhërrëfyes dhe me të drejtë edhe ju i keni përmendur. Unë do të doja të fokusohesha shumë shkurtimisht te disa nga detyrimet që burojnë nga Udhërrëfyesi, sikurse është miratimi i një strategjie të re për antikorrupsionin, e cila është përmendur gjithashtu edhe në progresraport. Në përgjigje të këtij detyrimi ne kemi hartuar një dokument strategjik në bashkëpunim me të gjitha institucionet, i cili adreson një pjesë të konsiderueshme të çështjeve që ju keni ngritur në analizën tuaj.

Do të dëshiroja, gjithashtu, që nëse është e mundur të kemi edhe shkëmbime të mëtejshme në lidhje me mënyrën se si shikoj që adresohen më mirë këto detyrime.

Për sa i përket sektorit privat, për herë të parë në strategji përfshihet një objektiv specifik, i cili adreson integritetin në biznes. Nuk ka qenë i përfshirë më parë dhe besoj se edhe analiza dhe diskutimi që është elaboruar në kuadër të punës së kryer nga ekspertët ushqen diskutimin që është i nevojshëm, që përveç integritetit në sektorin publik të përqendrojmë vëmendjen, gjithashtu, edhe në këtë drejtim. Sikurse buron edhe nga detyrimet që Shqipëria ka në kuadër të procesit të negociatave, brenda vitit 2027 Shqipëria do të duhet të ratifikojë Konventën e OCD-së për çështjet e parandalimit të ryshfetit në transaksionet ndërkombëtare të biznesit, një çështje, e cila sigurisht që do të jetë pjesë e debatit dhe e diskutimit dhe me të drejtë është ngritur edhe nga ju në analizën që parashtruat.

Gjithashtu, për sa u përket çështjeve të menaxhimit të riskut të korrupsionit në ndërmarrjet shtetërore, unë dëshiroj realisht t'ju përgëzoj për analizën e kryer në lidhje me këtë sektor. Ka qenë një nga organizatat e shoqërisë civile, e cila në krye të herës, që në muajin korrik të këtij viti, e ngriti si shqetësim që përveç sektorëve me risk që ka trajtuar strategjia, siç është sektori i pronave,

sektori i prokurimeve publike, sektori i tatimeve dhe doganave, sektori i shëndetësisë, sektori i arsimit, do të duhet që të përqendrojmë vëmendjen edhe te një fushë me interes të veçantë, sikurse është parandalimi i korrupsionit në ndërmarrjet me pronësi publike, ose kur pjesa më e madhe e aksioneve i përkasin shtetit. Për këtë arsye ne kemi përfshirë edhe një masë të re në strategji, pikërisht për të adresuar vlerësimin e riskut në këta sektorë apo në këto fusha, në të cilat presupozohet se edhe vigjilenca do të jetë më e lartë për shkak të faktit se këto institucione gjithsesi janë mbartëse të një detyrimi publik për të qenë më transparente, për të pasur mekanizma integriteti dhe mekanizma të forcuara llogaridhënie në raport me strukturat e tjera si bizneset private, të cilat operojnë në një treg të hapur.

Gjithashtu, në këtë drejtim, ajo çfarë adresohet në strategji është vlerësimi i riskut nga njëra anë, sepse duke ndërmarrë analiza të mirëfillta të vlerësimit të riskut jemi më të përgatitur për të adresuar dhe mitiguar riskun aty ku ai është më persistent. Natyrisht në këta sektorë risku mbetet më persistent dhe besoj se edhe në takimet e ardhshme do të kemi mundësi t'i diskutojmë më në detaje risqet në këta sektorë.

Do të doja të përmendja këtu një çështje që u ngrit në prezantimin e dytë për konsultimin publik. Kjo u përket më shumë çështjeve që lidhen me administratën publike dhe kryesisht detyrimeve që burojnë nga Udhërrëfyesi për Reformën në Administratën Publike për të ngritur në një tjetër nivel konsultimin publik jo vetëm në qeveri, por edhe në Kuvend.

Lidhur me çështjen që e ngriti zonja Arqimandridi, duke u nisur nga fakti që një pjesë e organizatave të shoqërisë civile thoshin se nuk marrim mjaftueshëm njoftim për projektligjet apo projektaktet që parashtrohen për konsultim, përmes AKSH-it, përpara një viti, ne kemi përfshirë në sistem një element të ri, ku për çdo projektakt të ri, të gjitha organizatat e shoqërisë civile, të cilat janë regjistruar paraprakisht, kanë shprehur vullnetin që duan të marrin informacion nga ky portal për çështje të caktuara, sipas tematikave ku ato kanë interes, u shkojnë automatikisht si njoftim. Pra, do të thotë se që në momentin e parë që ngarkohet në sistem një projektligj në fushën e bujqësisë, u shkon automatikisht të gjitha organizatave, të gjitha dhomave, të cilat kanë shprehur interesin për të marrë informacion në lidhje me konsultimin publik në këto fusha. Ne e kemi parë se që në momentin kur është përfshirë ky mekanizëm i ri në sistem, ka një lloj rritje angazhimi, sikurse ka edhe një lloj rritje të *feedback*-ut të pyetjeve ose të komenteve që vijnë.

Doja të ndaja shumë shkurt përvojën që ne kemi pasur jo më pak se disa javë më parë me Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, për të cilën kemi marrë mbi 45 komente jo vetëm

nga platforma, por edhe nga tryezat. Meqë një pjesë e mirë e aktorëve që kanë qenë të përfshirë në tryezë, janë prezent edhe këtu, i falënderoj përzemërsisht! Të gjithë kontribuuesve iu është dërguar një *e-mail* mbrapsht me komente, nëse komenti i tyre është pranuar plotësisht apo pjesërisht, ose nëse ka pasur raste, kanë qenë 8 në total, ku komenti iu është refuzuar, për ta sqaruar se pse iu është refuzuar apo se pse komenti nuk mund të reflektohet. Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit vërtet shtrihet deri në vitin 2030, por Plani i Veprimit shtrihet deri në vitin 2026 dhe natyrisht që do të duhet të kemi një racionalizim të të gjitha masave.

Në fund nga radha, por jo nga rëndësia, dëshiroj të sqaroj një çështje që ka të bëjë me ligjin për sinjalizimin. Ligji për sinjalizimin, që është aktualisht në fuqi, ka përafruar direktivën asokohe të vitit 2005 të OSBE-së, por sikurse e dini ka një direktivë të re, që është miratuar në 2019-n në rang BE-je, ku edhe një pjesë e mirë e vendeve anëtare ende janë në proces transpozimi. Dua të theksoj arsyen se pse BE-ja e miratoi një direktivë të re në 2019-n, sepse praktikisht legjislacioni për sinjalizimin në vendet e BE-së ka një nivel zbatimi shumë të dobët. Kjo vjen, sepse vetë mekanizmi i sinjalizimit shoqërohet me risqe, për shkak se një pjesë e mirë e risqeve kanë vështirësi edhe mitigimin. Po ju marr si shembull që në direktivën e re parashikohet që do të duhet t'u jepet mbrojtje jo vetëm subjekteve nëse ai apo ajo denoncon një rast brenda organizatës, brenda institucionit ose edhe brenda një biznesi privat, sepse, sikurse e dini, i gjithë sistemi i sinjalizimit shtrihet edhe në bisedat private, të cilat kanë mbi 80 punonjës. Në këtë rast është e qartë që mekanizmat, që parashikon legjislacioni i BE-së, nuk ishin mjaftueshëm mbrojtës...

Ilda Muçmataj – Zonja Rystemi, ju lutem!

Jonida Rystemi – Do ta mbyll edhe pak.

Dhe parashikohet shprehimisht që do të ketë mekanizma mbrojtës edhe ndaj familjarëve të personit që denoncon.

Këtu dua të sqaroj një gjë: nuk ka një mbivendosje në lidhje me kompetencën që ka Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Pasurive për sa i përket menaxhimit të gjithë sistemit të sinjalizimit, duke qenë se sinjalizuesi është një punonjës i brendshëm i institucionit. Koordinatorët kundër korrupsionit nuk janë struktura të brendshme të institucionit, janë funksionarë, të cilët varen drejtpërdrejt nga Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit dhe raportojnë ndaj tij. Që do të thotë se funksioni është i ndryshëm dhe arsyeja pse është mbajtur i ndryshëm, është pikërisht krijimi i kësaj distance midis institucionit nga njëra anë, natyrisht, dhe rolit që ka koordinatori për të mbikëqyrur procese që lidhen me llogaridhënien dhe me integritetin.

Ne mbetemi të hapur. Unë sot jam në takim me të gjithë kolegët e Drejtorisë Antikorrupsion, që ndjekin këtë proces, dhe jemi, natyrisht, të hapur në çdo kohë që të shkëmbejmë çdolloj informacioni ose çdolloj sqarimi që ju e gjykoni me vend.

Faleminderit!

Ilda Muçmataj – Faleminderit për komentet!

Ka ndonjë koment apo diskutim?

E ftuar – Nëse më lejohej, do të dal pak nga pjesa që mbuloj, ndoshta për t'i dhënë një përgjigje zonjës për pjesën e propozimit për sektorin privat, një ligj që ka të bëjë me *corporate social responsibility*. Edhe kur ka qenë pjesa e hartimit, ne jemi konsultuar me profesoreshë Jonidën dhe kemi qenë gjatë gjithë kohës në diskutimin sa duhet të ketë një mbirregullim për sektorin privat, sidomos edhe për organizatat e tjera joqeveritare, sepse ndonjëherë mbirregullimi mund të sjellë atë bumerangun ose efektin e kundërt. Shpeshherë është parë edhe në nivel global që një mbirregullim, sidomos në këto fusha, sjell atë që quhet perde e dritareve ose *greenwashing*, që përdoret pjesa e mjedisit për të pastruar aktivitetet e tjera. Kështu që, është shumë delikate. Për atë që ka të bëjë me integritetin në shoqëri, duhet të mundohemi që ne ta angazhojmë dhe ta aktivizojmë sektorin privat, por edhe aktorët e tjerë që të jenë nismëtarë të nismave të brendshme, patjetër pa mohuar ato që mund të jetë pjesë e përputhshmërisë. Pra, të shkojmë përtej përputhshmërisë, por duhet të vijë si një vetërregullim. Si sektori privat, edhe shoqëria civile funksionojnë shumë më mirë kur vijnë në formatin e vetërregullimit. Kjo ka qenë edhe qasja e të dyja aspekteve.

Ilda Muçmataj – Fjala për zonjën Rystemi.

Jonida Rystemi – Në fakt, për të adresuar edhe pak çështjen e marrëveshjeve për përcaktimin e ofertës, ne serish kemi këtu një mbivendosje me sektorët me risk të lartë, sepse ka qenë edhe objekt trajtimi i një çështjeje më vete që lidhet me sektorët me risk të lartë.

Një nga propozimet është krijimi i flamujve të kuq, pra i një platforme publike, ku të identifikohen dhe të nxirren të dhëna edhe në mënyrë indirekte për ofertues, të cilët me marrëveshje caktojnë ose përcaktojnë se cili do të jetë fituesi. Në këtë aspekt, ndoshta, ky mund të ishte një mekanizëm që mund të shërbejë si burim i mirë edhe për Autoritetin e Konkurrencës për të marrë nismën për ta hetuar rastin.

Lidhur me faktin nëse duhet të jetë një shkelje administrative apo të kriminalizohet si sjellje, sërish mendoj që kjo duhet koordinuar me politikën penale, në tërësi me grupin që është duke hartuar Kodin Penal.

Faleminderit!

Ilda Muçmataj – Faleminderit!

Fjala për zonjën Gjonaj për ndërhyrjen e fundit.

Etilda Gjonaj – Në radhë të parë, ju falënderoj të gjithëve që jeni pjesëmarrës në këtë tryezë me komentet, sugjerimet dhe vërejtjet për gjetjet paraprake të analizës, që është bërë për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit edhe nga grupi i punës, grupi i ekspertëve të nivelit të lartë, për këtë komponent, pasi çdo sugjerim dhe çdo koment ka një vlerë shumë të madhe për të gjithë këtë dokument dhe, pa dyshim, duhet kontributi i gjithsecilit edhe për këtë reformë që po ndërmerret nga Kuvendi.

Të gjithë e kuptojmë që si parandalimi, ndërgjegjësimi dhe lufta kundër korrupsionit nuk është pjesë e një aktori të vetëm apo e një institucioni të vetëm, por është pjesë e gjithë shoqërisë. Mund të flasim për ngritjen e sistemeve; mund të flasim për ndërtimin, hartimin dhe miratimin e ligjeve shumë të mira, por e dimë shumë mirë që gjëja kryesore, që do të duhet të jetë pjesë e saj, është ndryshimi i mentalitetit dhe i kulturës. Prandaj të gjitha grupet e interesit që janë këtu sot, aktorët më të rëndësishëm të shoqërisë civile, jeni ata të cilët kontribuojnë drejtpërdrejt edhe në këtë ndërgjegjësim, parandalim dhe në luftën kundër korrupsionit.

Së dyti, dua të theksoj që kjo është tryeza e dytë antikorrupsion, ku siç e patë janë ndërtuar bashkërisht dy komponentë shumë të rëndësishëm, që është komponenti për ndërtimin e një shoqërie me integritet, ku përfshihet roli i shoqërisë civile, ashtu siç u shpjegua, nga ana tjetër edhe rritja, por edhe mbrojtja e denoncuesve për rastet e denoncimit të korrupsionit, ku mbase do të duhet të shikohet, sepse mund të jetë një derë më e aksesueshme që qytetarët të denoncojnë korrupsionin, por, nga ana tjetër, pa dyshim edhe pjesën e sektorit privat, ku të dyja bashkë, se mund të duken që janë të ndryshme dhe, pavarësisht se u lanë me dy panele, janë pjesë e asaj çfarë e bën shoqërinë edhe në pjesën aktive dhe pasive të luftës kundër korrupsionit.

Ky nuk është një proces rutinë i Kuvendit. Bëhet fjalë për një reformë me një ambicie shumë të madhe që të ndërtojë pikërisht reforma në këto fusha, që do të përshpejtojnë procesin e integritetit europian. Pa dyshim shtylla antikorrupsion është një ndër shtyllat më sfiduese; është konceptuar për t'u konsideruar si një reformë transversale. Prandaj ajo fillon me korrupsionin

politik të zyrtarëve të lartë dhe të zgjedhurve, më pas në atë çka konsiderohet korrupsion në administratën qendrore dhe vendore, veçanërisht, ashtu siç u tha edhe këtu, e fokusuar në sektorët më me risk, siç janë pronat, doganat, tatimet, prokurimet publike, duke përfshirë njëkohësisht mekanizmat monitorues dhe mbikëqyrës të përdorimit të fondeve publike, të financave publike, por edhe për ta parë në konceptin e asaj çfarë konsiderohet korrupsioni transnacional apo që shërben për investimet që kanë influenca të huaja, malinje, njëkohësisht atë çfarë konsiderohet pastrim i parave, patjetër ajo çfarë trajtuam sot, që është pjesa e ndërtimit të një shoqërie me integritet.

Mund të them me shumë bindje që ky që dëgjuat sot, nuk është një dokument i komisionit, por është një dokument pune, siç u prezantua, i ekspertëve të niveli të lartë, dokument i cili, pasi të konsultohet me të gjithë aktorët, do të konsiderohet final, do të dorëzohet dhe më pas do të bëhet pjesë e dokumenteve të komisionit.

Për këtë arsye unë e ritheksoj edhe një herë që e vlerësoj maksimalisht kontributin tuaj sot dhe në vijim, i cili mund të jepet me shkrim apo edhe nëpërmjet uebsajtit të dedikuar “www.masl.al”, ku pa dyshim, duke e konsideruar si një ndër fazat më të rëndësishme të procesit, do të jetë, gjithashtu, një ushqim shumë i mirë për të plotësuar të gjithë analizën dhe gjetjet që grupi i ekspertëve të nivelit të lartë kanë realizuar, duke përfshirë edhe mendimet, sugjerimet dhe vërejtjet tuaja, që më pas do të na çojnë në një dokument me zgjidhjet reformuese në luftën kundër korrupsionit.

E fundit, por jo nga rëndësia, më lejoni të falënderoj dhe të shpreh të gjithë mirënjohjen e komisionit, por edhe mirënjohjen time personale, meqenëse si nga *background*-i, por edhe për faktin që kam ndjekur shtyllën antikorrupsion, për grupin e ekspertëve të nivelit të lartë, edhe të sekretariatit teknik, që janë pedagogë të Fakultetit të Drejtësisë dhe të Fakultetit të Ekonomisë, për aktorë të shoqërisë civile, të shoqatave të biznesit dhe institucioneve të pavarura, që kanë punuar për analizën, për të cilët absolutisht kam vlerësimin maksimal për profesionalizmin dhe seriozitetin dhe të gjithë angazhimin e ndërmarrë deri më tani.

Gjatë kësaj periudhe ndodh që na kanë shkruar, edhe mua më kanë shkruar personalisht ekspertë të ndryshëm, profesionistë të fushave që mbulojnë korrupsionin, që duan të angazhohen si ekspertë, por, për sa kohë që metodologjia e punës së këtij komisioni ka qenë e tillë që ekspertët kanë ardhur pikërisht në këto katër kategori, që unë sapo përmenda, pa dyshim, për të krijuar një grup ekspertësh të cilët janë të pavarur, nga ana tjetër edhe sa më profesionistë.

Në fund dua vërtet të falënderoj profesoreshë Jonida Rystemajn dhe profesoreshë Ilda Muçmatajn, që kanë drejtuar të dy komponentët, patjetër edhe Sofjanën, që vijnë nga fakulteti, Arditën që vjen nga shoqatat e biznesit, edhe Monikën nga fakulteti për të gjithë prezantimin dhe punën që bënë sot. Gjithashtu, kam edhe një falënderim për sekretariatit teknik dhe stafin e Kuvendit për organizimin e kësaj tryeze, patjetër pa lënë pa përmendur edhe përkthyesit që na e lehtësuan komunikimin nga shqip në anglisht për miqtë tanë dhe ekspertët ndërkombëtarë.

Faleminderit!

Ilda Muçmataj – Faleminderit!

Besoj se kjo është mbyllja.

MBYLLET MBLEDHJA

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Koordinator i Komisionit